




Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

  
Berghof Foundation



# Perspektivat Komunitare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri

Redion Qirjazi & Romario Shehu

Rasti  
studimor 4

### Rreth studimit

Rasti studimor i Shqipërisë është kryer së bashku me tre studimet e tjera të cilat mbulojnë Bosnjë dhe Hercegovinën, Kosovën dhe Maqedoninë, në kuadër të projektit studimor “Mundësitë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Ballkanin Perëndimor”. Së bashku me katër partnerët lokalë të hulumtimit, ne shqyrtojmë pse disa komunitete janë veçanërisht të prekur nga individë të frymëzuar nga dhe/ose që bashkohen me Shtetin Islamik (ISIS) ose grupe të ngjashme të ekstremizmit të dhunshëm, ndërkohë që komunitete të tjera mund të tregojnë qëndresë më të madhe ndaj të njëjtit fenomen. Bazuar në gjetjet e hulumtimit, partnerët e projektit do të zhvillojnë fushata informimi dhe nisma të dialogut lokal, në bashkëpunim me aktorët lokalë dhe komunitetet e prekura, me qëllim që të shqyrtojnë dhe zhvillojnë strategji për parandalimin e radikalizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor.

### Rreth autorëve

**Redion Qirjazi** është studiues pranë Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në Shqipëri. Më parë, ai ishte oficer i ushtrisë shqiptare për më shumë se shtatë vjet, një negociator kulturor në emër të ekipeve të NATO-s dhe lider në projekte të ndryshme të sigurisë dhe zhvillimit, si dhe në role të ndryshme. Fusha e tij e hulumtimit përqendrohet tek siguria kombëtare, mbrojtja, terrorizmi, zgjidhja e konflikteve, ekstremizmi i dhunshëm, Ballkani Perëndimor dhe zhvillimi në nivel strategjik dhe operacional.

**Romario Shehu** është hulumtues i ri dhe asistent projekti pranë Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në Shqipëri. Fusha e tij e hulumtimit ka në fokus çështjet e sigurisë, qeverisjes së mirë dhe demokracisë, të tilla si radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm, anti-korrupsioni, administrata publike dhe rritja e qëndresës në komunitet. Romario ka diplomë MSc në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe diplomë BA në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare.

### Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Rr. “Shenasi Dishnica”, Ndërtesa 35, Hyrja 1, 1017, Tiranë, Shqipëri

Për më shumë informacion vizitoni: <http://idmalbania.org/>

### Mirënjohje

Ky projekt dhe studimet e tij mbështeten financiarisht nga Ministria Federale Gjermane për Punët e Jashtme



Auswärtiges Amt

Layout & Desktop publishing në anglisht: Astrid Fischer

Layout & Desktop publishing në shqip: Eduart Cani

© 2018 Berghof Foundation Operations GmbH. All rights reserved.

Për të cituar këtë studim: Redion Qirjazi & Romario Shehu 2018. Perspektivat e Komunitetit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Shqipëri. Rasti studimor 4. Berlin/Tirana: Berghof Foundation dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM).

<<http://image.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Papers/>. Botimi i parë: 17/10/2018

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe mendimet e Fondacionit Berghof ose partnerët e tij.

### Berghof Foundation

Altensteinstraße 48a

14195 Berlin

Germany

[www.berghof-foundation.org](http://www.berghof-foundation.org)

[info@berghof-foundation.org](mailto:info@berghof-foundation.org)

# Tabela e përmbajtjes

<b>Lista e shkurtesave</b>	<b>2</b>
<b>Përmbledhje Ekzekutive</b>	<b>3</b>
<b>1. Hyrje</b>	<b>4</b>
1.1. Konteksti i përgjithshëm	4
1.2. Historiku i vendit	5
1.3. Qëllimi dhe arsyetimi i studimit	8
<b>2. Metodologjia</b>	<b>10</b>
2.1. Hartimi i studimit dhe arsyetimi	10
2.2. Instrumentimi (Protokolli i Intervistës; Procedurat e Mbledhjes së të Dhënave)	10
2.3. Kufizimet	11
<b>3. Paraqitja dhe analiza e të dhënave</b>	<b>12</b>
3.1. Raste studimore: Bashkitë e Tiranës, Korçës dhe Kavajës	12
3.2. Nivelet e perceptuara të EDH-së	13
3.3. Faktorët dhe aktorët e qëndresës dhe cenueshmërisë	14
3.3.1 Faktorët ideologjikë	15
3.3.2 Faktorët socio-ekonomikë	20
3.3.3 Faktorët strukturorë	23
3.4. Programe dhe nisma për PEDH-në/LKEDH-në	26
3.4.1. Programet dhe nismat qeveritare	26
3.4.2. Shoqëria civile dhe komunitetet fetare	28
3.4.3. Nisma konkrete për rastet studimore (Korçë, Tiranë, Kavajë)	28
3.5. PEDH-ja dhe përpjekjet për vendosjen e paqes dhe për pajtim.	29
<b>4. Përfundime dhe rekomandime</b>	<b>31</b>
<b>Fjalorth</b>	<b>35</b>
<b>Bibliografia</b>	<b>38</b>

# Lista e shkurtesave

<b>BIRN</b>	Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative
<b>CONTEST</b>	Strategjia e Kombeve të Bashkuara Kundër Terrorizmit
<b>OSHC</b>	Organizata të Shoqërisë Civile
<b>LKEDH</b>	Lufta Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>LH</b>	Luftëtarët e Huaj / LHT – Luftëtarët e Huaj Terroristë
<b>FG</b>	Fokus Grupe
<b>IDM</b>	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
<b>ISIS</b>	Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë
<b>KMSH</b>	Komuniteti Mysliman Shqiptar
<b>NATO</b>	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
<b>OJF</b>	Organizata Jofitimprurëse
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PEDH</b>	Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm
<b>RUSI</b>	Instituti i Shërbimeve të Bashkuara Mbretërore
<b>UN CTITF</b>	Task Forca e Kombeve të Bashkuara për Zbatimin e Strategjisë Kundër Terrorizmit
<b>UNDP</b>	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
<b>USAID</b>	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
<b>EDH</b>	Ekstremizmi i Dhunshëm

# Përmbledhje Ekzekutive

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka fituar shumë vëmendje në arenën ndërkombëtare si një vend që eksporton luftëtarë të huaj (LH) dhe mbështetës të tjerë të organizatave të ndryshme terroriste, të përfshirë në përlëshjet gjatë luftës në Siri. Gjatë hartëzimit të vendeve të origjinës së ekstremistëve të dhunshëm dhe LH-ve, vihet re që shpërndarja e tyre brenda vendit nuk është e njëjtë. Përkundrazi, ata janë të përqendruar në disa komunitete të vogla. Rasti më i njohur ishte ai i xhamisë së Yzberishtit, që ndodhet në një lagje të Tiranës, ku mbi 70 persona u shndërruan në radikalë dhe u larguan nga vendi për të mbështetur grupe të ndryshme militante në Siri. Si rrjedhojë, ky studim përqendrohet te komuniteti si njësisia kryesore e analizës dhe qëllimi i tij kryesor është që të ndihmojë së pari në zbulimin e faktorëve dhe aktorëve që i bëjnë komunitetet të qëndrueshme ose të cenueshme ndaj ekstremizmit të dhunshëm (EDH), dhe se si ndërveprojnë ato për të krijuar disa efekte të caktuara, dhe së dyti në identifikimin e veprimeve të mundshme për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në të ardhmen.

Ky studim shqyrtoi dallimet ndërmjet komuniteteve të prekura dhe atyre të paprekura nga fenomeni i EDH-së në tre bashki: Tiranë, Korçë dhe Kavajë, si përpjekje për identifikimin e shkaqeve strukturore, sociale dhe ideologjike përkatëse që janë përgjegjëse për këtë dallim të perceptuar ndërmjet komuniteteve (faktorët dhe aktorët). Ky studim në terren ka bërë të qartë se faktorët dhe aktorët e qëndrësës së komunitetit ndaj EDH-së ndahen në tre kategori kryesore: *ideologjike, socio-ekonomikë dhe strukturorë*. Faktorët ideologjikë përfshijnë ndjenjën e qëllimit, përkatësisë, pranimit, ndërgjegjësisë dhe edukimit, dhe lidhen kryesisht me perceptimet individuale të zemërimit, që mund të kontribuojnë më vonë në akte dhune. Faktorët socio-ekonomikë përfshijnë mënjanimin, marginalizimin, privimin ekonomik dhe rrjetet sociale. Aktorët dhe faktorët strukturorë lidhen me marrëdhënien e personave me shtetin ose institucionet e tjera, si komunitetet fetare.

Sipas këtij studimi, faktorët e qëndrësës dhe cenueshmërisë kanë gjasa të jenë të pranishëm si te komunitetet e prekura, ashtu edhe tek ato të paprekura, por në nivele të ndryshme. Faktorët që ndihmojnë dhe parandalojnë EDH-në vihen re si te komunitetet e prekura, ashtu edhe tek ato të paprekura, por ka edhe faktorë ndërhyrës shtesë që mund të “nxisin” cenueshmërinë në disa komunitete në rrezik. Prandaj, prekshmëria nuk mund të përcaktohet nga prania e dukshme e faktorëve dhe aktorëve që janë në favor të cenueshmërisë ndaj EDH-së, por nga niveli, dinamikat dhe kombinimi i faktorëve dhe aktorëve të një komuniteti të caktuar. Si rrjedhojë, qëndresa është një spektër dhe sistematike (gjithëpërfshirëse), ndërsa radikalizimi ndaj EDH-së është një proces, shkalla e të cilit varet kryesisht (por jo vetëm) nga niveli i qëndrësës.

Gjithashtu, ky studim pohon se EDH-ja lindi si bashkim i ideologjisë, zemërimit dhe mundësisë, që buron nga ndërveprimi midis faktorëve ideologjikë, strukturorë dhe socio-ekonomikë të cenueshmërisë. Të gjithë faktorët dhe aktorët madhorë ndikojnë te një komunitet duke formësuar një prej këtyre tre mundësuesve të EDH-së. Megjithatë, ndikimi negativ i ideologjisë, zemërimit dhe mundësisë për t'u bërë ekstremist i dhunshëm mund të shmanget kryesisht nëpërmjet (1) kohezionit social, (2) vlerave qytetare të përforcuara, (3) bashkëpunimit të shtuar ndërmjet aktorëve të komunitetit, dhe (4) performancës institucionale të përmirësuar.

Siç vihet re në nivele të ndryshme në të tre komunitetet, angazhimi dhe veprimi proaktiv nga ana e aktorëve të komunitetit janë thelbësorë në forcimin e qëndrësës, më shumë sesa mungesa e dukshme e faktorëve të cenueshmërisë. Aktorët mund të kenë ndikim negativ në qëndrësën ose cenueshmërinë e një komuniteti, pasi ata ose mund të ndihmojnë në uljen e cenueshmërisë, ose mund të nxisin zemërimin dhe të rrisin cenueshmërinë. Për më tepër, aktorët mund të shërbejnë si forca mobilizuese për një ideologji të përbashkët nëpërmjet formësimit të perceptimeve dhe trajtimit të zemërimit.

Nga rastet studimore të përzgjedhura, Kavaja ka treguar qëndrësë më të madhe ndaj EDH-së, e ndjekur nga Korça dhe Tirana. Ky përfundim mbështetet edhe nga nivelet e vëzhguara të prekshmërisë nga EDH-ja në secilin prej këtyre komuniteteve.

# 1 Hyrje

## 1.1. Konteksti i përgjithshëm

Në vijim të ‘Pranverës Arabe’, e cila shënoi përhapjen e revolucioneve në Afrikën e Veriut dhe në Lindjen e Mesme, në mars të vitit 2015 shpërtheu konflikti i armatosur dhe lufta civile në Siri (Romero, 2018). Si pasojë e menjëhershme, forcat kundërshtarë filluan një qëndresë të armatosur ndaj regjimit të presidentit sirian Bashar al-Assad. Megjithatë, në fund të vitit 2012 dhe gjatë vitit 2013, shumë fraksione guerilase u bënë pjesë e organizatës terroriste, e njohur si Shteti Islamik i Irakut dhe Sirisë (ISIS). Si pjesë e kontributit në rritjen e shpejtë të ISIS-it në vitin 2013 dhe 2014, një lëvizje xhihadiste solli mijëra luftëtarë të huaj në Sirinë dhe Irakun e shkatërruar nga lufta, me premtimin e rikthimit të kalifatit islamik (Bunzel, 2015, 25-36).

Vendet e Ballkanit Perëndimor nuk ishin imune ndaj ideologjisë së frymëzuar nga ISIS-i, që përmes propagandimit të një pikëpamjeje botërore sipas së cilës Islami ishte nën kërcënim, nguliti zemërimin te popullatat myslimane vendase. Propaganda e ISIS-it pati ndikim domethënës në mobilizimin e LH-ve nga Ballkani Perëndimor, pasi deri në nisjen e luftës në Siri, “më pak se dhjetëra persona të njohur nga Ballkani Perëndimor ishin angazhuar në veprimtarinë e luftëtarëve të huaj” (Holman, 2014, 2). Megjithëse raportet ndryshojnë, numri i përgjithshëm i LH-ve nga Ballkani Perëndimor në Siri nga fundi i vitit 2012 deri në fundin e vitit 2015, mendohet se ishte rreth 950 persona, ku shumica e luftëtarëve vinin nga Kosova (316), Bosnja dhe Hercegovina (240), Maqedonia (140-150), dhe Shqipëria (140) (Azinović 2017, 1-2).<sup>1</sup> Në krahasim me fluksin e madh të LH-ve nga vendet e Evropës Perëndimore, vendet e Ballkanit Perëndimor vazhdonin të ruanin shifra luftëtarësh nën mesataren për frymë ndërmjet popullsisë myslimane brenda secilit vend (Azinović 2017, 2-3).

Vlen të theksojmë se brenda secilit vend të sipërpërmendur, numri mbizotërues i LH-ve e ka burimin nga komunitetet e vogla të identifikuar veçmas. Për shembull, në rastin e Shqipërisë, dy zona të vogla në Pogradec dhe një xhami e veçantë në Tiranë kanë kontribuar me mbi dy të tretat e LH-ve të Shqipërisë. Në këtë rast, mund të ndërtojmë paralele me qytetet e vogla të Ovse dhe Gornje Maoče në Bosnjë dhe Hercegovinë (Beslin dhe Ignjatijevic, 2017, 2). Në Kosovë, dy bashkitë e vogla pranë kufirit me Maqedoninë, Hani i Elezit dhe Kaçaniku, kanë pasur përkatësisht norma pesë dhe dy herë më të larta të mobilizimit sesa banorët e bashkisë belge të Sint-Jans-Molenbeek, që shpesh konsiderohet si vatra e nxehtë e EDH-së në Evropën Perëndimore (Shtuni, 2016). Ky model duket se pasqyrohet edhe në Maqedoni, ku nga komunitetet e Gazi Baba, Çairit, dhe bashkia e Kumanovës ka dalë shumica e LH-ve që u larguan për të luftuar në Siri dhe Irak (Selimi dhe Stojkovski, 2016, 49-53).

Fenomeni i radikalizimit, EDH-së dhe LH-së e kanë prekur Shqipërinë në të gjithë territorin e saj dhe kanë ndikuar në jetën socio-politike; megjithatë, hartëzimi i vendeve të origjinës së EDH-së tregon se disa komunitete shfaqen më të prekshme nga ideologjia ekstremiste e frymëzuar nga ISIS-i sesa të tjerat. Gjithashtu, duke pasur parasysh faktin se këto komunitete janë relativisht të vogla si në popullsi edhe në shpërndarjen gjeografike, është e dukshme se ky fenomen nuk mund t’i atribuohet vetëm fatit ose motiveve individuale, por edhe faktorëve që e prekin komunitetin në tërësi. Prandaj, nëse EDH-ja mund të kushtëzohet nga faktorët në nivel komuniteti, është vendimtare që të shqyrtohet dhe analizohet fenomeni duke përdorur ‘komunitetet’ si njësi të analizës. Njohja e faktorëve dhe aktorëve themelore, që e bëjnë komunitetin më të cenusur (ose më të qëndrueshëm) ndaj EDH-së, mund të ofrojë perspektiva të reja për këtë problem, si dhe të ndihmojë në gjetjen e zgjidhjeve më gjithëpërfshirëse për trajtimin e tij.

1 Shihni edhe Progres Raportet e Komisionit Evropian për Vendlindjen për të dhëna krahasuese, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/package\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/package_en)

## 1.2. Historiku i vendit

Pas më shumë se 25 vitesh sistemi demokratik qeverisjeje, Shqipëria mbetet një vend në tranzicion nëpër shumë linja socio-politike. Megjithëse është një vend anëtar i NATO-s dhe kandidat për anëtarësim në BE, Shqipëria ende përballet me shumë sfida lidhur me zhvillimin, mirëqeverisjen, dhe shtetin e së drejtës, korrupsionin dhe llogaridhënien politike, si dhe nxitjen e bashkëpunimit rajonal në përputhje me parimet e BE- së. Sipas censusit më të fundit, Shqipëria ka një popullsi prej mbi 2.8 milionë banorësh, ndërsa katër komunitetet e saj fetare më të mëdha janë: komuniteti mysliman (57 për qind), katolik (10 për qind), ortodoks (shtatë për qind) dhe bektashi (dy për qind) (Instituti Shqiptar i Statistikave, 2011).<sup>2</sup>

Megjithëse feja nuk luan rol shumë domethënës për shumicën e shqiptarëve, identiteti shoqëror, kulturor dhe kombëtar është shumë i rëndësishëm. Në fakt, raporti i fundit për *Tolerancën Fetare në Shqipëri* ka nxjerrë në pah se identiteti i fortë kombëtar ndikon në tolerancën fetare, ku mbi 80 për qind e shqiptarëve besojnë se “identiteti kombëtar nxit tolerancën fetare” (Vurmo et al., 2018, 25). Një arsye se përse identiteti fetar nuk është mbizotërues në Shqipëri është fakti se vendi ushqehet me kulturën tradicionale të shkëmbimeve reciproke të praktikave fetare dhe kulturën e pranimit dhe gjithëpërfshirjes. Sipas të njëjtit raport për *Tolerancën Fetare në Shqipëri*, shqiptarët kanë një “kuptueshmëri fetare të madhe dhe solidaritet ndërkulturor”, gjë që bie në sy edhe në festimet e zakonshme të festave fetare dhe në martesat ndërfeitare (po aty., 10). Megjithëse shumica e feve në Shqipëri duket se bashkëjetojnë në harmoni, kryesisht sepse “shumica e shqiptarëve bëjnë jetë laike: ata kanë pak informacion ose njohuri për fenë, dhe refuzojnë gjykimet fetare për formësimin ose kushtëzimin e mënyrës së tyre të jetesës,” (po aty, 4) në fakt, komunitetet fetare nxisin vazhdimisht tolerancën, dhe nuk e marrin tolerancën fetare për të mirëqenë. Në këtë kontekst, toleranca kuptohet si respekt ndaj besimeve të të tjerëve, pavarësisht mosdakordësisë me to, dhe zakonisht nxitet nga respekti për të drejtat e njeriut dhe solidariteti; ose siç vërteton Scanlon, është “qëndrimi se ajo është diçka që qëndron midis pranimit me plot zemër dhe kundërshtimit të pakufizuar (Scanlon, 1996, 226).”

Megjithatë, është e rëndësishme që të mos e barazojmë tolerancën me indiferencën apo mungesën e paragjykitimit të anës tjetër, pasi këto cilësi janë të rëndësishme për të mundur fillimisht ekzistencën e tolerancës (Eisenstein, 2008, 18-19). Nga ana tjetër, harmonia nënkupton përzemërsi reciproke ndërmjet të gjitha feve dhe është një doktrinë filozofike e papërshtatshme për kontekstin shqiptar, pavarësisht faktit se shumë do ta preferonin atë; toleranca fetare është më e përshtatshme (Vurmo et al., 2018, 21).

Për shkak se toleranca fetare ka qenë një traditë e kahershme për shoqërinë shqiptare, çuditërisht në konfliktin në Siri morën pjesë shumë luftëtarë të huaj të Shqipërisë, gjë që ngjalli një shqetësim të madh publik dhe ngriti pyetje se çfarë kontribuoi në shfaqjen e fenomenit. Kjo situatë i detyroi autoritetet të pranojnë se vendi kishte një problem me EDH-në. Megjithëse ekstremistët e dhunshëm kanë abuzuar me Islamin, ishte e qartë se feja luajti një rol të rëndësishëm në vendimet e personave për t’u bërë luftëtarë të huaj, dhe si rrjedhojë, publiku kërkonte përgjigje dhe shpjegime nga komuniteti mysliman.

Feja në Shqipëri ka një të shkuar historike, që është dukshëm e ndryshme nga ajo e shumë vendeve fqinje. Në vitin 1967, Shqipëria u bë zyrtarisht i vetmi vend ateist në botë, dhe regjimi komunist përforcoi një doktrinë të mohimit fetar që synonte eliminimin e të gjitha formave të identitetit fetar te publiku (Vickers, 2008, 1). Në vitin 1991, kushtetuta e themeluar rishtazi mundësoi lirinë e besimit fetar, duke lejuar *ndarjen e fesë nga shteti* (Shteti Web, 2013). Falë lirisë fetare të themeluar së fundmi, ndikimi i komuniteteve fetare në Shqipëri u rrit me kalimin e kohës dhe në vitet pasuese të periudhës tranzitore shqiptare; xhamitë dhe kishat u ndërtuan me shpejtësi në të gjithë vendin (Dyrmishi, 2017, 26-27). Gjithashtu, dukej se Islami në Shqipëri po përjetonte një ndryshim të vogël në formë, duke kaluar nga favorizimi i identitetit kombëtar te theksimi i identitetit fetar. Një shembull i thjeshtë i këtij kalimi në kulturën institucionale mund të vihet re në statutin e Komunitetit Mysliman Shqiptar (KMSH), i cili në

2 Megjithatë, vlerësimet e tjera ndryshojnë. Në studimin “Hartëzimi i Popullsisë Botërore Myslimane (2012)”, Qendra Studimore “Pew” evidenton se popullsia myslimane shqiptare përbën 80% të popullsisë së përgjithshme të vendit, ndërsa në “Librin e Fakteve Botërore”, Agjencia Qendrore e Inteligjencës e Shteteve të Bashkuara evidenton se vetëm 60% e popullsisë është myslimane.

vitin 1993 shprehej se objektivi i tij kryesor ishte “të rriste e zhvillonte ndjenjën e përzemërsisë e besnikërisë për atdheun dhe popullin shqiptar”, por në vitin 2005, objektivi i tij ishte “të përhapte, zgjonte dhe forconte tek besimtarët myslimanë besimin Islam, të mbronte dinjitetin, të drejtat dhe interesat e myslimanëve, të rriste e zhvillonte ndjenjën e përzemërsisë e besnikërisë për atdheun dhe popullin shqiptar.”<sup>3</sup> Megjithëse kjo nuk është domosdoshmërisht problematike, kjo tregoi një shkëputje progresive ndërmjet KMSH-së dhe qeverisë së Shqipërisë, dhe si rrjedhojë krijoi një vështirësi potenciale për nivelin e angazhimit ndërmjet shtetit dhe Komunitetit Mysliman, që do të ishte e dëmshme në vitet pasardhëse (2012-2015).

Mungesa e koordinimit ndërmjet qeverisë së Shqipërisë, komuniteteve vendore dhe KMSH-së uli monitorimin në nivel vendi të veprimtarisë fetare dhe zgjeroi mundësitë për ideologjitë fetare radikale për të hyrë në vend. Në vitin 1992, në përpjekje për të tërhequr investimet e huaja, qeveria e Shqipërisë iu bashkua Organizatës së Konferencës Islamike; megjithatë, pak kohë më vonë, ky vendim solli investime nga grupe të veçanta Uahabi dhe Salafi, të cilat sollën në vend një ideologji radikale (BIRN, 2014). Në të njëjtën kohë, lidhshipi i dobët dhe jo shumë i aftë i KMSH-së krijoi përplasje brenda komunitetit, pasi shumë imamë që kishin praktikuar Islamin në Lindjen e Mesme filluan të sfidonin pikëpamjet tradicionale të brezit të vjetër të imamëve, të cilëve shpesh iu mungonin disa kualifikime pas viteve të privimit fetar nën regjimin komunist (Zoto, 2013, 50 -51). Si rrjedhojë, ndërmjet viteve 1991 dhe 2005, gjashtë OJF të rëndësishme që kishin lidhje me terrorizmin u vendosën në Shqipëri pa dijeninë e qeverisë (Kullolli, 2009, 42-47). Prandaj, operacionet e suksesshme kundër terrorizmit të qeverisë së Shqipërisë (me mbështetje nga Perëndimi) iu dhanë fund veprimtarive të tyre (po aty, 45-47). Ideologjia e EDH-së e ndaloi rrugëtimin e saj, së bashku me planet e LH-ve të Shqipërisë në luftërat ballkanike. Ndërkohë, është e rëndësishme të nxjerrim në pah kontekstin e vendit në atë periudhë: ajo që mund të ketë kontribuar në mungesën e interesit të shqiptarëve për të marrë pjesë në luftërat ballkanike nuk ishte fakti se ideologjia radikale ishte në fazat e saj të para, por edhe mungesa e përgjithshme e identitetit fetar dhe sfidat socio-ekonomike gjerësisht të përhapura të vendit në tranzicion.

Në vitin 2011, Shqipëria përjetoi për herë të parë fenomenin e pjesëmarrjes së luftëtarëve të huaj në Siri, por shumica e LH-ve të Shqipërisë udhëtuan drejt Sirisë gjatë viteve 2012-2013, dhe më pak gjatë vitit 2014. Duke pasur parasysh periudhën kur ata u nisën drejt Sirisë (para krijimit të fraksioneve kryesore terroriste), u duk sikur qytetarët shqiptarë u larguan nga vendi për të luftuar me forcat e opozitës siriane kundër regjimit sirian. Me përshkallëzimin e konfliktit dhe ndarjen e opozitës në grupime të ndryshme, qytetarët shqiptarë luftuan më pas në emër të organizatave terroriste, si ISIS, Fronti al-Nusra, dhe Jaysh al-Islam në Siri dhe Irak.

Disa nga luftëtarët e parë të Shqipërisë që shkuan në Siri vinin nga zona të varfra, të izoluara dhe të pafavorizuara. Këto zona vizitoheshin shpesh nga imamë të jashtëm, ose imamë jozyrtarë që angazhoheshin në predikim. Siç u bë e dukshme më vonë, ky nuk ishte rast që lidhej veçanërisht me zonat e vogla apo të izoluara, pasi një grup prej nëntë imamësh të vetëshpallur u arrestuan në Tiranë me akuzën e mbështetjes së terrorizmit nëpërmjet rekrutimit të LH-ve për ISIS-in (Shqipëri: Ekstremizmi dhe Lufta Kundër Terrorizmit, 2017). Shumë LH të Shqipërisë u larguan drejt Irakut dhe Sirisë në fazat e para të konfliktit, ndërsa shumica e atyre që u kthyen e bënë një gjë të tillë brenda dy muajsh nga nisja e tyre. Sipas dy studimeve të kryera në vitin 2015, arsyet që çuan në shfaqjen e këtij fenomeni mund të grupohen në tre kategori kryesore: izolimi socio-ekonomik, praktikat fetare të pakontrolluara jashtë Islamit tradicional, dhe pasiviteti institucional (mungesa e aftësisë për të ndikuar në jetën e njerëzve) (Vurmo et al., 2015, 110-113).<sup>4</sup> Radikalizimi ndodhi kryesisht në komunitetet e izoluara, ku shumica e individëve i përkasin grupmoshës 19-29 vjeç (Spahiu, 2017, 37). Faktorët socio-ekonomikë që ndikojnë radikalizimin përfshijnë institucionet jofunksionale, korrupsionin dhe mungesën e transparencës së qeverisjes, punësimin, dhe faktorët ekonomikë (Azinović, 2017, 13). Gjithashtu, luftëtarët e huaj përjetojnë izolim ideologjik gjatë të cilit zhvishen nga identiteti i tyre i mëparshëm, pasi përqafojnë ideologjitë radikale. Ky proces kërkon kohë, ndërsa individët piren të tërhiqen nga jeta sociale dhe politike (MAPO, 2014).

3 Në vitet 1993 dhe 2005 përkatësisht, në nenin 2 të Statutit të Komunitetit Mysliman Shqiptar u shpall misioni dhe vizioni i KMSH: link: <http://licodu.cois.it/?p=220> (1993) dhe <http://licodu.cois.it/?p=226> (2005).

4 Shihni edhe Hide, 2015, 27-36.



Megjithëse të dhënat për LH-të e Shqipërisë nuk janë njësoj në të gjitha burimet e informacionit, shumë prej tyre kanë pak dallime. Raporti më i fundit, i cili u bazua te të dhënat zyrtare të qeverisë, ishte Raporti i Komisionit Evropian (KE) për Shqipërinë 2018, i cili tregoi se ndërmjet viteve 2012-2015, 144 shqiptarë u nisën drejt Sirisë; nga të cilët 45 u kthyen, 26 u vranë dhe 73 vazhdojnë të jenë në fushëbetëj (18 luftëtarë dhe 55 familjarë) (Komisioni Evropian, 2018, 36). Gjithashtu, raporti pohon se, që prej vitit 2015, asnjë qytetar shqiptar nuk ka shkuar në Siri.

Në përgjithësi, qeveria e Shqipërisë mori masa të menjëhershme për të luftuar kërcënimin e EDH-së dhe për të frenuar individët që të marrin pjesë në konflikte të huaja; megjithatë, ka disa zona ku përpjekjet e qeverisë së Shqipërisë për të parandaluar dhe luftuar EDH-në, mungojnë ose kanë nevojë për përmirësim. Aktualisht, megjithëse supozohet se rreth 45 qytetarë janë kthyer nga zonat e konfliktit, qeveria e Shqipërisë nuk ka dënuar apo arrestuar asnjë prej tyre. Si arsye për këtë paraqitet fakti se shumica prej tyre u kthyen para ndryshimeve në legjislacion dhe miratimit të Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit. Si rrjedhojë, nevoja për të targetuar ata individë nëpërmjet programeve specifike pengohet nga fakti se ata nuk ishin në kundërvajtje me ligjin në atë periudhë (Telegrafi, 2014). Mungesa e personave të kthyer të identifikueshëm (luftëtarë të huaj dhe qytetarë) e bën të pamundur zbatimin e përpjekjeve konkrete për deradikalizimin në vend (të paktën zyrtarisht), ndërsa nga ana tjetër këto përpjekje mund ta ndihmonin shoqërinë civile dhe qeverinë të hartonin strategji efektive për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (LKEDH) në të ardhmen.

Përveç humbjes së mundësisë për t'u angazhuar në qasjet transformuese ndaj EDH-së, të cilat fillojnë me deradikalizimin, një tjetër fushë ku qeveria e Shqipërisë ka mbetur pas është trajtimi i propagandës së EDH-së dhe radikalizimit në internet. Sipas raportit më të fundit të KE-së, “përmbajtja e radikalizimit në internet në gjuhën shqipe është në rritje.” (Komisioni Evropian, 2018, 37) Ky pretendim mbështetet edhe nga studime kërkimore të pavarura të kryera në vitin 2017. Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative (BIRN) arriti në përfundimin se “Shqipëria nuk kërcënohet vetëm për faktin se është pjesë e koalicionit [kundër ISIS-it], por ajo kërcënohet edhe nga përhapja e madhe e mbështetësve në internet [të ekstremizmit të dhunshëm], që nesër mund të veprojnë si ujçerë të vetmuar” (Bogdani, A. 2016, 7-8), ndërsa një raport nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë konfirmoi nivele të larta të propagandës së EDH-së në faqe interneti në gjuhën shqipe, të cilat edhe pse mbylleshin, shfaqeshin sërish me emra të ndryshëm (Kelmendi dhe Balaj, 2017). Megjithëse radikalizimi në internet nuk mund të sjellë kërcënim të menjëhershëm, sigurisht që ai mund të rrezikojë qëndrueshmërinë dhe sigurinë e vendit në të ardhmen.

Një fushë e dytë dhe më e rëndësishme që kërkon vëmendje është ngritja e mekanizmave parandalues për të luftuar EDH-në, në vend të përqendrimit të mbrojtja dhe kundërmasat. Pjesa më e madhe e trajtimit të mësipërm tregon se shumica e përpjekjeve të qeverisë shqiptare janë përqendruar te *reagimi* ndaj kërcënimeve të EDH-së sesa te përpjekja për formësimin e së ardhmes së mjedisit të sigurisë (dhe socio-politik). Ky ndryshim modeli është i rëndësishëm, pasi përqendrohet në zgjidhjen e problemit. Gjithashtu, asnjë nivel mbrojtjeje nuk mund të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha cenueshmëritë. Për shembull, kërcënimet, si sulmet nga të ashtuquajturit “ujçerë të vetmuar” do të vijojnë të ekzistojnë, pasi sipas natyrës së tyre këta individë shfrytëzojnë ‘çarjet’ në sistem, dhe për këtë arsye mbeten jashtë sferës së parashikueshmërisë (Michael, 2014, 46-47).

Fatkeqësisht, ky *hendek* në zbatimin e strategjisë dhe politikave pasqyrohet edhe në studim. Shqyrtimi i literaturës aktuale për EDH-në në Shqipëri tregon se nuk është punuar shumë për njohjen e faktorëve dhe aktorëve që kontribuojnë në qëndresën ose cenueshmërinë e komunitetit ndaj EDH-së. Mungesa e studimit krijon një zbrazëti njohurish dhe kufizon kapacitetet për marrjen e vendimeve të informuara.

Raportet e para për këtë temë, që u publikuan në vitin 2015, trajtonin nxitësit e EDH-së dhe radikalizimin, dhe ndihmuan në krijimin e një konteksti strategjik, historik dhe rajonal për fenomenin e EDH-së. Puna e parë thelbësore, *Radikalizimi Fetar dhe Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri*, hodhi themelet për punën në të ardhmen, ndihmoi në formësimin e punës së shumë institucioneve që merren me EDH-në, dhe shërbeu si bazë për studime të mëtejshme akademike (Vurmo et al., 2015). Raporti i dytë, *Ekstremizmi i Dhunshëm dhe Radikalizimi fetar në Shqipëri*, ndihmoi në paraqitjen e çështjeve në shkallë më të gjerë duke ofruar kontekst shtesë për fenomenin, megjithëse ai u përqendrua kryesisht në

përshkrimin e përgjithshëm të problemit, prezantimin me faktet dhe një analizë të shkurtër të faktorëve nxitës (Hide, 2015).

Janë edhe disa studime të tjera që mbulojnë fenomenin e LH-ve të Shqipërisë. Për shembull, *Midis Shpëtimit dhe Terrorit: Radikalizimi dhe Fenomeni i Luftëtarëve të Huaj më Ballkanin Perëndimor* trajton shkurtimisht pasojat e kontingjentit shqiptar të LH-ve (Azinović, 2017). Raporti përmban dy kapituj për ndikimet fetare shqiptare në radikalizimin që çon drejt EDH-së. Ai arrin në përfundimin se keqinformimi, së bashku me praktikën e pakontrolluar të fesë, kanë rritur gjasat për radikalizimin e shqiptarëve. Raportet e tjera kanë targetuar ndarjen e statistikave për kontingjentin e LH-ve etnikë shqiptarë nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria, dhe trajton karakteristikat individuale që i shtojnë disa individë drejt rekrutimit (Shtuni, 2015a, 460-477).<sup>5</sup> Së fundmi, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë publikoi një raport për përdorimin e medias online si një platformë për radikalizimin dhe përhapjen e propagandës së EDH-së në komunitetin shqipfolës (Kelmendi dhe Balaj, 2017). Raporti u përqendrua te Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia, dhe ofroi një përshkrim të nivelit të rrezikut të krijuar nga media online, si dhe të ndikimit që ajo mund të ketë në vetëradikalizimin dhe radikalizimin në përgjithësi. Raporti është i dobishëm pasi thekson rëndësinë e kanaleve të komunikimit, të cilët shërbejnë si faktorë mundësues të EDH-së.

Deri më tani, studimi për EDH-në në Shqipëri është përqendruar në dy aspekte kryesore: së pari, në njohjen dhe ndërgjegjësimin për çështjen e gjerë të radikalizimit dhe EDH-së në Shqipëri, dhe së dyti në shpjegimin e nxitësve dhe mekanizmave mundësues të radikalizimit dhe EDH-së. Nga ana tjetër, janë kryer pak studime për faktorët që ndikojnë në qëndresën ose cenueshmërinë e komunitetit ndaj EDH-së, dhe akoma edhe më pak studime për strategjitë që mundësojnë qëndresën e komunitetit për parandalimin e këtij kërcënimi në të ardhmen.

### 1.3. Qëllimi dhe arsyetimi i studimit

Qëllimi kryesor i këtij studimi është që të ndihmojë së pari në njohjen e faktorëve dhe aktorëve që i bëjnë komunitetet të qëndrueshme ose të cenueshme ndaj EDH-së, dhe se si ndërveprojnë ata në krijimin e efekteve, dhe së dyti në identifikimin e veprimeve të mundshme për parandalimin e EDH-së në të ardhmen. Gjithashtu, ai synon të japë rekomandime për përmirësimin e aftësisë së komuniteteve për marrjen e masave parandaluese.

Studimi u përqendrua në tre bashki të Shqipërisë. Ndryshe nga pjesa më e madhe e literaturës për rajonin dhe temën, e cila përqendrohet kryesisht në faktorët e përgjithshëm shtytës dhe tërheqës, apo në nxitësit e përgjithshëm të EDH-së, ky studim shqyrton dallimet ndërmjet komuniteteve të prekura dhe të paprekura, si dhe synon identifikimin e shkaqeve përkatëse strukturore, sociale dhe ideologjike që janë përgjegjës për dallime të tilla (faktorë dhe aktorë).

Duke njohur shpërndarjen e pabarabartë të EDH-së nga njëri komunitet te tjetri, ky studim thekson rëndësinë e analizimit të faktorëve të cenueshmërisë dhe qëndresës në nivel komuniteti.<sup>6</sup> Një qasje me bazë komunitare është dobiprurëse për disa arsye. Së pari, ajo zgjeron njohjen e shkaqeve të EDH-së dhe ofron një bazë të gjerë njohurish ku do të përqendrohen veprimet e ardhshme të politikave. Së dyti, analiza e faktorëve dhe aktorëve shoqëruar nuk është as shumë e gjerë dhe as shumë specifike, siç ndodh në rastin e përqendrimit tek analiza në nivel kombëtar ose individual, dhe si rrjedhojë ajo mund të jetë më vepruese. Nga ana tjetër, politika në nivel kombëtar ‘një i përshtatet të gjithëve’ për parandalimin e EDH-së, ka qenë mjaft e përgjithshme dhe e papërshtatur me karakteristikat e veçanta të secilit komunitet (Vurmo et al., 2015, 15). Po ashtu, është shumë e vështirë që shumë projekte, të cilat synojnë çështje shumë specifike lidhur me EDH-në në Shqipëri, të zbatohen për shkak të vështirësive në identifikimin e rasteve specifike dhe në angazhimin e duhur për to.<sup>7</sup> Së treti, duke u përqendruar te

5 Shihni edhe Adrian Shtuni, “Luftëtarët e Huaj Etnikë Shqiptarë në Irak dhe Siri,” Qendra Kundër Terrorizmit: Sentinel, Vëll. 8, Nr. 4, prill 2015.

6 Termi ‘komunitet’ do të shpjegohet më poshtë në studim.

7 Për shembull, ka shumë debat për deradikalizimin dhe trajtimin e luftëtarëve të huaj të kthyer në Shqipëri, dhe megjithëse mbi 40 prej tyre besohet se janë kthyer, nuk ka informacione se kush mund të jenë ata dhe nuk është marrë asnjë masë në favor apo kundër tyre.

komunitetet vendore, projektet e ardhshme kanë një mundësi të mirë për të qenë *vepruese*. Kjo ndodh sepse strukturat komunitare gjenden më pranë kujdesit të përditshëm të qytetarëve të tyre; ato kanë më shumë dijeni për sfidat me të cilat përballen njerëzit; dhe për shkak se secili komunitet është i veçantë, ato mund t'i identifikojnë më mirë faktorët që mund të nxisin EDH-në në komunitetin e tyre të veçantë. Gjithashtu, komunitetet shërbejnë si një pikë lidhjeje e jetës sociale, politike, ekonomike dhe personale, që nënkupton se janë pika kontakti rreth të cilave njerëzit angazhohen në veprimtaritë e tyre të përditshme. Rrjedhimisht, përqendrimi te komunitetet mund të ketë një ndikim më të menjëhershëm në jetën e qytetarëve. Së katërti, nëpërmjet njohjes më të mirë të mjedisit të komunitetit, politikëbërësit do të angazhohen më shumë me aktorët vendorë për hartimin e politikave të efektshme që synojnë EDH-në. Së fundi, qasja me në qendër komunitetin vlerëson ndërhyrjen dhe strukturën e aktorëve vendorë, që mundësojnë më shumë veprim dhe llogaridhënie. Ndërhyrja nënkupton “mundësinë e subjektit (individit ose grupit) për të vepruar, kontrolluar dhe transformuar mjedisin social,” (Block, 2013, 134) ndërsa struktura nënkupton modelin e rregullimeve sociale, që “sapo krijohet, formëson dhe kushtëzon ndërhyrjen” (po aty.). Si rrjedhojë, për shkak të lidhjeve të drejtpërdrejta sociale dhe institucionale që strukturat komunitare kanë me individët dhe anasjelltas, theksimi i qasjeve me në qendër komunitetin mund të përmirësojë si pjesëmarrjen e individëve, ashtu edhe veprimet e strukturave komunitare.

Gjithashtu, raporti do të përcaktojë rolet specifike që mund të luajnë palët përkatëse të interesit për t'i bërë komunitetet më të qëndrueshme dhe për të pakësuar rreziqet në të ardhmen nëpërmjet zbatimit të mekanizmave parandalues. Ai do të hedhë dritë edhe te cenueshmëritë dhe kërcënimet e fjetura, të cilat mund të ekzistojnë si te komunitetet e prekura, ashtu edhe tek ato të paprekura, dhe do të identifikojë mekanizmat e mundshëm nxitës që mund ta transformojnë një komunitet të paprekur në një komunitet ku lind EDH-ja. Ai është i rëndësishëm për dy arsye. Së pari, ai evidenton se cenueshmëritë janë pjesë e pandarë e komunitetit, dhe si rrjedhojë ‘lokalizimi’ i problemit konfirmon se ‘problemet vendore kërkojnë zgjidhje vendore’. Së dyti, rezultatet e studimit do të ndihmojnë në ndjekjen e qasjeve të orientuara drejt komunitetit dhe pushtetit vendor për përmirësimin e qëndrësës; dhe jo vetëm ndaj EDH-së së nxitur nga feja, por edhe ndaj fenomenit në përgjithësi.

Për të kuptuar se çfarë i bën komunitetet ‘të qëndrueshme’ ndaj EDH-së dhe se si mund t'i përforcojnë ato kapacitetet e tyre për të luftuar dhe parandaluar EDH-në në të ardhmen, ky studim synon t'iu përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

1. Cilët janë faktorët kyç të qëndrësës ose cenueshmërisë së komunitetit ndaj individëve dhe grupeve që shfaqin besime ekstremiste të dhunshme dhe iu bashkohen grupeve të huaja ekstremiste të dhunshme (dhe cili është roli që luajnë këta faktorë)?
2. Cilët aktorë ndikojnë në cenueshmërinë ose qëndrësën e komunitetit ndaj EDH-së dhe si i formësojnë ata këto dinamika?
3. Cila është rëndësia e programeve ekzistuese të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm (PEDH) në Ballkanin Perëndimor në trajtimin e faktorëve aktualë të cenueshmërisë ose qëndrësës komunitare ndaj EDH-së?
4. Cilat lidhje mund të identifikohen ndërmjet veprimtarive të PEDH-së dhe përpjekjeve për vendosjen e paqes dhe pajtimin në Ballkanin Perëndimor?
5. Cilat janë pikat hyrëse kyçe për programimin dhe reagimin e përmirësuar të PEDH-së në Ballkanin Perëndimor?

Raporti është ndarë si në vijim. Kapitulli dy trajton metodologjinë e përdorur në këtë studim. Kapitulli tre paraqet të dhëna dhe ofron një analizë të faktorëve të qëndrësës dhe cenueshmërisë ndaj prekshmërisë nga EDH-ja, si dhe trajton efektshmërinë e programeve aktuale për parandalimin e EDH-së dhe pikat e mundshme hyrëse për vendosjen e paqes dhe programet e PEDH-së. Kapitulli katër paraqet përfundime dhe rekomandime për masa politikash në të ardhmen.

## 2 Metodologjia

### 2.1. Hartimi i studimit dhe arsytimi

Qëllimi kryesor i këtij studimi është njohja se çfarë i bën komunitetet të qëndrueshme ndaj EDH-së; rrjedhimisht, ai përqendrohet në analizimin e karakteristikave të komunitetit sipas kontekstit të dhënë socio-ekonomik, ideologjik dhe politik. Studimi përfshiu tre faza: shqyrtimin e literaturës së mëparshme dhe informacioneve përkatëse për temën, punën në terren në komunitetet e zgjedhura për kontekstualizimin e fenomenit, dhe analizën e të dhënave të mbledhura.

Ky studim përcaktoi bashkitë si nivelin më efikas të komunitetit për analizim. Bashkitë janë njësi të dobishme të analizës pasi ato mund të sigurojnë një përfaqësim gjithëpërfshirës të “komunitetit”, duke shërbyer si pikë lidhjeje ndërmjet komuniteteve vendore dhe institucioneve shtetërore. Bashkitë sigurojnë kuadër të mirë për komunitetin, jo vetëm si një komunitet (qytet) kulturor, por edhe administrativ me institucionet përkatëse shtetërore dhe vendore që funksionojnë në të. Në rastin kur bashkitë janë tepër të mëdha për t’u përputhur me kriterin e komunitetit ‘vendor’, studimi shtrihet në lagje të veçanta të zgjedhura. Së fundi, bashkitë janë njësi të analizës të nënstudiuara për sa i përket EDH-së dhe ia vlen që ato të studiohen, me qëllim përcaktimin e mekanizmave alternative për parandalimin e EDH-së. Tre bashkitë e përzgjedhura ishin Tirana (tre lagje), Korça dhe Kavaja.

Këto bashki u zgjodhën për karakteristikat e tyre unike si komunitete, si dhe lidhur me potencialin e tyre për nxitjen e ideologjisë dhe veprimeve të EDH-së në të ardhmen. Tre kriteret që u përdorën në përzgjedhjen e bashkive për rastet studimore ishin *numri i LH-ve, komunitetet që nuk ishin studiuar më parë dhe përbërja fetare*. Këto bashki u zgjodhën për të përfaqësuar një gamë të gjerë të nivelit të prekshmërisë nga EDH-ja, që vlerësohet nga numri i luftëtarëve të huaj (LH) nga secili komunitet. Megjithatë të dhënat nuk janë bindëse për numrin e saktë, pasi autoritetet nuk kanë nxjerrë asnjë raport të veçantë, studimet e mëparshme kanë evidentuar Tiranën si komunitetin që ka nxjerrë numrin më të madh të LH-ve (Çobo, 2016). Dy bashkitë e tjera nuk kishin të dhëna për LH-të. Qëllimi i përdorimit të përbërjes fetare si kriter është për të vlerësuar nëse toleranca fetare gjithëpërfshirëse (Vurmo et al., 2018) dhe diversiteti fetar ndikojnë në radikalizimin brenda komuniteteve. Për ta zbuluar këtë, të intervistuarve dhe pjesëmarrësve në fokus grupe (FG) iu kërkua të përshkruanin se sa ndërveprojnë komunitetet fetare me njëri-tjetrin, dhe se si perceptohet diversiteti fetar brenda këtyre komuniteteve.

### 2.2. Instrumentimi (Protokolli i Intervistës; Procedurat e Mbledhjes së të Dhënave)

Puna në terren u krye në dy forma kryesore: intervista me informuesit kyç dhe me FG-të. Burimet kryesore ndahen në tre kategori: shërbimet e sigurisë, pushteti vendor dhe udhëheqësit e komunitetit fetar. Në total u kryen 19 intervista, nga të cilat dhjetë u kryen me udhëheqës fetarë, pesë me përfaqësues të forcave të sigurisë (kryesisht punonjës policie), dhe katër me zyrtarët e pushtetit vendor. Në total u organizuan shtatë fokus grupe në të tre komunitetet, ku mbi 80 persona morën pjesë në diskutime dhe ndanë mendimet e tyre. FG-të u krijuan duke pasur parasysh tre konsiderata të rëndësishme: (1) theksin te pikëpamjet e formësuara nga përvojat personale të secilit pjesëmarrës, (2) diversitetin ndërmjet pjesëmarrësve për të shmangur ‘mendimin në grup’ dhe perceptimet e ngjashme, dhe (3) ndërgjegjësimin për temat e radikalizimit, EDH-së, dhe çështjet e përgjithshme të sigurisë. Krahas këtyre karakteristikave të rëndësishme, në to u përfshinë edhe specifika të tjera, si diversiteti fetar, gjinia (përveç një grupi që përbëhej vetëm nga gra myslimane), angazhimi në jetën socio-politike të komunitetit, puna me institucionet vendore ose shtetërore brenda komunitetit, dhe mosha. Përzgjedhja e të intervistuarve u krye bazuar në pozicionet zyrtare të të intervistuarve (për shembull

‘drejtori i policisë vendore’ ose ‘imami i Kavajës’), ndërsa përzgjedhja e pjesëmarrësve në FG u krye më ndihmën e organizatave vendore pas përcaktimit të kriterëve të përzgjedhjes.

Të dyja veprimtaritë, si intervistat edhe FG-të u administruan nëpërmjet një pyetësoi gjysmë të strukturuar të dakordësuar më parë. Diskutimet u regjistruan dhe më pas në shumicën e rasteve u zbardhën; megjithatë, u mbajtën shënime për disa intervista për të cilat pjesëmarrësi refuzoi që të regjistrohej. Si pjesë e etikës së këtij studimi, pjesëmarrësit ishin gjithmonë në dijeni të qëllimit të studimit dhe rolit të tyre në këtë studim, dhe ishin njohur me natyrën e bashkëpunimit të tyre, duke përfshirë pranimin e marrëveshjes së konfidencialitetit.

### 2.3. Kufizimet

Ky studim dhe përpjekjet e tij për të hedhur dritë tek ajo që i bën komunitetet të qëndrueshme ndaj EDH-së kanë disa kufizime. Ato përfshijnë shtrirjen e komuniteteve të analizuara, vështirësitë në përcaktimin e komuniteteve që janë më të rrezikuara, pamundësinë për t’u përqendruar në më shumë institucione brenda një komuniteti të dhënë, dhe përfshirjen e më shumë individëve në studim. Gjithashtu, studimi përqendrohet vetëm në zona të veçanta gjeografike të Shqipërisë, dhe rrjedhimisht nuk mund t’i përgjigjet të njëjtës pyetje në mënyrë gjithëpërfshirëse për qarqet e tjera. Gjithashtu, studimi përqendrohet kryesisht te “komuniteti” si njësi e analizës dhe përpiqet të identifikojë disa nga faktorët dhe aktorët që e bëjnë komunitetin të qëndrueshëm. Megjithatë, këto përgjigje nuk janë shteruese dhe faktorë të tjerë, që janë të jashtëm për komunitetin vendor, mund të kenë ndikim të madh në nivelin e qëndrësës/cenueshmërisë së një komuniteti të caktuar. Së fundi, ndërkohë që përqendrohet te komunitetet si vendndodhja e faktorëve të qëndrësës, studimi mund të nënvlerësojë rëndësinë e individëve dhe vendimet e tyre për angazhimin në veprimtari ekstremiste.

## 3 Paraqitja dhe analiza e të dhënave

### 3.1. Raste studimore: Bashkitë e Tiranës, Korçës dhe Kavajës



*Tirana*, kryeqyteti i Shqipërisë që prej vitit 1920, është qyteti më i madh dhe më i rëndësishëm i Shqipërisë. Sipas censusit më të fundit, ajo ka një popullsi prej 557,422 banorësh (megjithëse sot njihet si metropol me rreth 1,000,000 qytetarë) (Instituti Shqiptar i Statistikave).<sup>8</sup> Për sa i përket përbërjes fetare,

55.7 për qind e qytetarëve të saj janë myslimanë, 6.4 për qind janë ortodoksë, 5.4 për qind janë katolikë dhe 3.4 për qind janë bektashinj (Instituti Shqiptar i Statistikave). Pjesa më e madhe e qytetarëve të Tiranës, 70.9 për qind, i përket grupmoshës 15-64 vjeç, 18 për qind janë fëmijë, dhe pjesa tjetër prej 10.6 për qind janë mbi 64 vjeç. Në Tiranë, 31.4 për qind e qytetarëve kanë përfunduar vetëm arsimin fillor (8-9 vite arsimim), 65.9 për qind e tyre kanë përfunduar të paktën shkollën e mesme (12 vite arsimim), dhe vetëm 25.3 për qind kanë përfunduar arsimin universitar ose pasuniversitar (15+ vite arsimim). Niveli i papunësisë në Tiranë është 24.3 për qind, ku rreth gjysma e të rinjve (48 për qind e tyre) janë të papunë (Instituti Shqiptar i Statistikave).

*Korça* është qyteti kryesor i Shqipërisë Juglindore. Sipas censusit më të fundit, ajo ka një popullsi prej 75,994 banorësh. Sipas përbërjes fetare të qytetarëve të saj, 46.9 për qind janë myslimanë, 28.2 për qind janë ortodoksë, 2.2 për qind janë bektashinj dhe 1.4 për qind janë katolikë (Instituti Shqiptar i

Statistikave). Pjesa më e madhe e qytetarëve të Korçës, 67.6 për qind, i përket grupmoshës 15-64 vjeç, 16.4 për qind janë fëmijë nën 15 vjeç, dhe pjesa tjetër prej 15.9 për qind janë mbi 64 vjeç. Në Korçë, 49.2 për qind e qytetarëve kanë përfunduar vetëm arsimin fillor (8-9 vite arsimim), 46.2 për qind e tyre kanë përfunduar të paktën shkollën e mesme (12 vite arsimim), dhe 13.8 për qind kanë përfunduar arsimin universitar ose pasuniversitar (15+ vite arsimim). Niveli i papunësisë në Korçë është 27.2 për qind, ku më shumë se gjysma e të rinjve (55.3 për qind e tyre) janë të papunë (Instituti Shqiptar i Statistikave).

*Kavaja* ndodhet në rajonin e Ultësirës Perëndimore të Shqipërisë. Sipas censusit më të fundit, ajo ka një popullsi prej 40,094 banorësh. Sipas përbërjes fetare të qytetarëve të saj, shumica dërmuese (87.7 për qind) janë myslimanë, 3.9 për qind janë ortodoksë, 0.6 për qind janë katolikë dhe 0.4 për qind janë bektashinj (Instituti Shqiptar i Statistikave). Pjesa më e madhe e popullsisë, 66.4 për qind i përket grupmoshës 15-64 vjeç, 20.1 për qind janë fëmijë, dhe 13.5 për qind janë të moshuar. Në Kavajë, pjesa më e madhe e qytetarëve, 58.8 për qind kanë përfunduar vetëm arsimin fillor (8-9 vite arsimim), 35.4 për qind e tyre kanë përfunduar të paktën shkollën e mesme (12 vite arsimim), dhe vetëm shtatë për qind kanë përfunduar arsimin universitar ose pasuniversitar (15+ vite arsimim). Niveli i papunësisë në Kavajë është 29.5 për qind, ku më shumë se gjysma e të rinjve (55.2 për qind e tyre) janë të papunë (Instituti Shqiptar i Statistikave).

Megjithëse mungojnë të dhënat zyrtare, shqyrtimi i dokumentacionit tregoi se Kavaja nuk ka pasur raste të raportuara për LH-të, diçka që më vonë u pohua edhe nga myftiu dhe shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet në Kavajë.<sup>9</sup> Qyteti i Korçës nuk ka pasur asnjë luftëtar të huaj, por nxitja e mendimit radikal ka qenë e

8 Censusi i vitit 2011 paraqet të dhënat më të fundit demografike në Shqipëri.

9 Këto pikëpamje u ndanë gjatë intervistave me shefin e policimit në komunitet dhe me myftiun e Kavajës.

pranishme si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale (BalkanWeb, 2015). Këto rezultate të shqyrtimit të dokumentacionit u bazuan edhe në punën në terren. Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet, në Korçë, deklaroi se megjithëse “në Korçë nuk ka pasur raste të LH-ve, as në qytet dhe as në fshatrat përreth... ka disa prirje të EDH-së, kryesisht në qytet dhe në disa raste pranë periferive, kryesisht njerëz që i përkasin komunitetit mysliman” (Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet, Korçë, 2018). Nga ana tjetër, periferitë e përzgjedhura të Tiranës dyshohet se kanë pasur mbi 70 luftëtarë të huaj (Çobo, 2016). Megjithatë, shumë projekte për luftën kundër EDH-së janë fokusuar në bashki të tjera të Shqipërisë për shkak të përqendrimit të lartë të LH-ve nga këto komunitete.

Tirana është një nga bashkitë ku ideologjia e EDH-së nuk ka qenë sporadike, por është përqendruar në zona të veçanta, që tregojnë se faktorët mund të kenë lidhje me komunitetin. Në përgjithësi, problemet që lidhen me PEDH-në janë shfaqur në ato zona ku popullsia vendase është zhvendosur nga qytetet e vogla, ose ku *lidhjet sociale* nuk janë të fuqishme apo shumë të ngulitura. Këto komunitete janë më të izoluara dhe periferike, si në rastin e periferive të Tiranës, që është pikërisht arsyeja se përse ato u zgjedhën si raste studimore.

### 3.2. Nivelet e perceptuara të EDH-së

Burimeve kyçe dhe pjesëmarrësve në FG iu kërkua mendimi lidhur me nivelin e EDH-së në komunitetet e tyre. Ndërmjet palëve të ndryshme të interesit, si dhe ndërmjet komuniteteve të ndryshme u vunë re disa prirje të dallueshme. Megjithatë, palët e interesit prireshin ta interpretonin fenomenin sipas pikëpamjeve të tyre personale. Për shembull, policia theksoi se kërcënimi është i pranishëm dhe serioz, ndërsa udhëheqësit fetarë u përpoqën të distancoheshin nga fenomeni. Në rastin e parë, duket se policia mund të ketë zhvilluar një vizion më të përqendruar te problemi duke ndjekur një ekzaminim të detajuar të secilit skenar. Gjithashtu, ata janë më të prirur ndaj shqyrtimit të situatës. Nga ana tjetër, distancimi nga ana e udhëheqësve fetarë mund të vijë si një formë e mospajtitit njohës me qëllim shmangien e shoqërimit me individë që e përdorin fenën e tyre për të kryer akte të dhunshme. Në përgjithësi, drejtuesit e pushtetit vendor nuk ishin aq të përqendruar te fenomeni sa në çështje të tjera të veprimtarive të tyre të përditshme. Qëllimi i këtij studimi nuk është të përcaktohet nëse një grup ka të drejtë apo e ka gabim, por ajo çka vlen të përmendet është dallimi ndërmjet perceptimeve dhe pikëpamjeve të secilit institucion.

Një nga arsyet se përse mund të ketë interpretime të ndryshme të nivelit të perceptuar të EDH-së në secilin komunitet, mund të lidhet me bashkëpunimin e kufizuar ndërmjet shtetit dhe institucioneve fetare. Është e qartë se institucionet shtetërore kanë pak besim te komunitetet fetare si partnerë të mundshëm. Kjo u konfirmua në dy raste nga krerët e komuniteteve myslimane në Korçë dhe Tiranë, të cilët theksuan nevojën për më shumë bashkëpunim nga ana e institucioneve shtetërore me Komunitetin Mysliman, si dhe nevojën e përgjithshme për fuqizimin e KMSH-së.<sup>10</sup> Për më tepër, studiuesi islamik Abu Nimer paralajmëron se komunikimi i njëanshëm me komunitetin mysliman nuk mund të krijojë besim të mjaftueshëm për bashkëpunim, dhe se “t’iu kërkosh udhëheqësve myslimanë një bekim apo të japin një “fatwa” (mendim fetar) në mbështetje të një politike, si dhe të mos i përfshish ata në politikëbërje *nuk* është angazhim komunitar” (Abu-Nimer, 2018, 15).

Reagimet në *fokus grupe* ishin të ndryshme. Nga ana tjetër, pothuajse çdo praktikant besonte se komuniteti i tyre karakterizohet nga harmonia fetare dhe respektimi i diversitetit. Këto ide ishin të përhapura midis shumë prej FG-ve, që përbëheshin nga një përzjerje e feve, gjinive, moshave dhe udhëheqësve të komunitetit. Kjo ishte e vërtetë sidomos për Korçën dhe Kavajën. Megjithatë, është interesante të theksojmë se kur pjesëmarrësve të FG-ve iu bënë pyetje për diskriminimin, gjuhën e urrejtjes dhe krijimin e stereotipave, nuancat e *radikalizmit të fshehur* dolën më shumë në pah. Termi ‘radikalizëm i fshehur’ duhet kuptuar si një formë e radikalizmit që nuk mund të vihet re nëpërmjet vëzhgimit të drejtpërdrejtë, por mund të dalë në pah nëpërmjet një analize të mëtejshme të nënteksteve të bisedave. Ajo çka është më e rëndësishme, kjo formë e radikalizmit nuk është e dukshme për njerëzit

10 Këto pikëpamje u ndanë gjatë intervistave me myftinjët e Korçës dhe Tiranës.

që mund ta shpërndajnë atë, ose për ata që janë në anën e përvetësimit të saj. Ky fenomen mund të shfaqet në formën e diskriminimit të fshehur, stereotipave ose epërsisë së besimit të një individi.<sup>11</sup>

Njohja e faktorëve të perceptuar dhe të vërtetë të radikalizimit dhe ekstremizmit mundëson analizën krahasuese ndërmjet asaj që komunikohet me fjalë dhe asaj që tregohet së brendshmi, shqyrtimin e ndryshimeve dhe pandryshueshmërive, dhe përcaktimin e mënyrës dhe arsyeve se përse mund të kenë ndodhur këto transformime. Pjesët e mëposhtme do të trajtojnë faktorët më të rëndësishëm që janë identifikuar përmes punës në terren.

### 3.3. Faktorët dhe aktorët e qëndresës dhe cenueshmërisë

Kategoritë e mëposhtme të faktorëve u përzgjedhën nëpërmjet një qasjeje nga poshtë-lart, duke mbledhur dhe analizuar opinionet dhe perceptimet e subjekteve të punës në terren. Në pjesën më të madhe të studimit në terren, doli në pah se faktorët dhe aktorët e qëndresës së komunitetit ndaj EDH-së ndaheshin në tre kategori të mëdha: *ideologjikë*, *socio-ekonomikë* dhe *strukturorë*. Arsyetimi që qëndron pas këtij grupimi është i dyfishtë. Së pari, ka pasur një model të vazhdueshëm të grupimit të bërë nga të intervistuarit dhe vetë pjesëmarrësit në FG. Kur u pyetën se çfarë mendonin për faktorët kryesorë që e bëjnë një komunitet të cenueshëm ndaj EDH-së, shumica e pjesëmarrësve përmendën ose kategoritë e mësipërme, ose renditën faktorë që i përkasin pikërisht një prej këtyre kategorive. Së dyti, dhe ndoshta më e rëndësishmja, një pjesë e mirë e literaturës akademike e mbështet këtë grupim të faktorëve që ndikojnë në cenueshmërinë dhe qëndresën ndaj EDH-së. Për shembull, Hafez dhe Mullins identifikuan tre kategori kryesore të faktorëve: “mjedisin mundësues dhe strukturat mbështetëse”, “ideologjitë ekstreme, rrjetet dhe lidhjet ndërpersonale” dhe “zemërimi kolektiv dhe personal” (Hafez dhe Mullins, 2015, 961), dy prej të cilave janë identifikuar edhe në modelin e këtij studimi. Një studim i Institutit të Shërbimeve të Bashkuara Mbretërore (RUSI) i identifikon “motivuesit strukturorë, nxitësit individualë dhe faktorët mundësues” si faktorët bazë që nxisin EDH-në (Khalil dhe Zeuthen, 2016, 9), që është një paraqitje e ngjashme e strukturës së propozuar në këtë raport, ku ‘faktorët mundësues’ nënkuptojnë shumë faktorë socialë dhe ekonomikë. Po ashtu, Udhëzuesi i USAID-it për Kuadrin e Vlerësimit të Konfliktit i identifikon “performancën institucionale, identitetin dhe modelet sociale” si tre motivuesit kryesorë që nxisin zemërimin dhe konfliktin (USAID, 2011).

Faktorët ideologjikë përfshijnë sistemin e besimit të individëve dhe janë themelet e identitetit të individit. Këta faktorë sigurojnë një ndjenjë qëllimi, përkatësie, dhe pranimi, dhe lidhen me perceptimet individuale të zemërimit që kontribuojnë në akte dhunë në të ardhmen. Faktorët socio-ekonomikë dhe strukturorë bazohen në kushte dhe krijojnë mjedisin e veçantë mundësues dhe kontekstin ku vepron një komunitet. Këta faktorë përfshijnë mënjanimin, marginalizimin, privimin ekonomik dhe rrjetet sociale, dhe mund të nxisin dhunën dhe mobilizimin ndaj dhunës. Së fundi, aktorët dhe faktorët strukturorë përfshijnë marrëdhënien ndërmjet individëve dhe institucioneve shtetërore, pushtetit vendor dhe institucioneve fetare, si komunitetet fetare.

Analiza e mëposhtme do të shqyrtojë lidhjen ndërmjet faktorëve të cenueshmërisë dhe qëndresës, dhe niveleve të prekshmërisë së secilit komunitet nga EDH-ja. Megjithëse parashikimi i lidhjes shkak-pasojë ndërmjet paprekshmërisë dhe faktorëve të qëndresës dhe anasjelltas (prekshmërisë dhe cenueshmërisë) nuk është i mundur, është e rëndësishme që të vëzhgohen të gjithë faktorët dhe aktorët e identifikuar të qëndresës dhe cenueshmërisë në të gjitha komunitetet e përzgjedhura, me qëllim njohjen e lidhjeve, modeleve dhe prirjeve brenda këtij zinxhiri (prekshmeri/paprekshmeri - cenueshmeri/qëndresë). Me fjalë të tjera, qëndresa është një koncept i ndryshueshëm dhe i vështirë për t’u përcaktuar në masë, ndaj analiza, në rastin më të mirë, mund të synojë të zbulojë se si lidhen këto variabla.

Cenueshmëria dhe qëndresa nuk janë të dyanshme (ose.../ose...), por ato ekzistojnë në një

<sup>11</sup> Disa nga aspektet e radikalizimit të fshehur do të trajtohen edhe në analizën e faktorëve dhe aktorëve, e cila kontribuon në prekshmeri.



spektër. Si rrjedhojë, faktorët e qëndresës dhe cenueshmërisë kanë gjasa të jenë të pranishëm si në komunitetet e prekura edhe në ato të paprekura, ndonëse në nivele të ndryshme. Prandaj, është e rëndësishme që faktorët dhe aktorët e qëndresës dhe cenueshmërisë të shqyrtohen në të tre komunitetet (Tiranë, Korçë dhe Kavajë) për të kuptuar më mirë se ku pozicionohen ato në spektrin e qëndresës. Pozicioni i saktë i komuniteteve për sa i përket qëndresës dhe cenueshmërisë është çështje interpretimesh, e bazuar në analizën e faktorëve dhe aktorëve, dhe në respektimin e prirjeve, modeleve dhe trajektoreve që shfaq komuniteti.

Tabela 1 paraqet faktorët dhe aktorët specifikë të qëndresës/cenueshmërisë, që do të analizohen në secilin komunitet për të njohur mënyrën dhe nivelin e ndikimit të tyre në prekmëri. Secili nga faktorët dhe aktorët e qëndresës dhe cenueshmërisë do të analizohen veçmas për secilin komunitet.

*Tabela 1: Matrica e faktorëve dhe aktorëve që prekin cenueshmërinë dhe qëndresën ndaj EDH-së*

	<b>Faktorët dhe aktorët që favorizojnë cenueshmërinë</b>	<b>Faktorët dhe aktorët që favorizojnë qëndresën</b>
<b>Ideologjikë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identiteti dhe ideologjia</li> <li>• Edukimi (i përgjithshëm ose fetar) jo i duhur ose mungesa e tij</li> <li>• Keqinformimi nëpërmjet propagandës fetare</li> <li>• Radikalizimi në internet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerat e shëndosha qytetare</li> <li>• Edukimi fetar për të ndërgjegjësuar</li> <li>• Kultura e përbashkët</li> </ul>
<b>Socio-ekonomikë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mënjanimi, marginalizimi, izolimi, diskriminimi</li> <li>• Privimi ekonomik dhe mungesa e mundësive</li> <li>• Krijimi i rrjeteve sociale</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lidhja/kohezioni social</li> <li>• Mundësitë e barabarta</li> </ul>
<b>Strukturorë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Perceptimet e qeverisjes së dobët</li> <li>• Mungesa e konsolidimit të pranisë shtetërore</li> <li>• Institucionet apatike të sigurisë Institucionet joefikase</li> <li>• Korrupsioni dhe pandëshkueshmëria</li> <li>• Tensionet brenda fesë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunimi i shtuar me institucionet</li> <li>• Angazhimi komunitar</li> </ul>
Është zbatuar në të tre komunitetet: Korçë, Tiranë dhe Kavajë		

### 3.3.1 Faktorët ideologjikë

a) *Ideologjia dhe identiteti* – Identiteti është “koncept i gjerë dhe gjithëpërfshirës, që pasqyron natyrën e individit dhe përbërjen e grupeve” (Jones, 2013, 105) dhe përkufizohet nga “norma, vlera, besime dhe qëndrime të përbashkëta që bashkojnë individë të ndryshëm në një njësi të vetme” (po aty.). Si i tillë, identiteti formëson mënyrën se si lidhen individët në një grup. Sipas James Fearon, identiteti ka kuptim të dyfishtë: social dhe personal. Identiteti personal përfshin “aspekte ose qëndrime të një personi që përbëjnë bazën e dinjitetit dhe vetërespektit të tij ose të saj”, ndërsa identiteti social është thjesht një “kategori sociale e përcaktuar nga rregullat e anëtarësisë, atributet karakteristike ose sjellja e pritshme” (Fearon, 1999, 10). Ky përkufizim vlen për diskutim në dy drejtime. Së pari, ai e lidh identitetin personal

me dinjitetin dhe vetërespektin, që, kur zbehet, mund të sjellë zemërim personal. Së dyti, ai tregon se identiteti social lidhet plotësisht me identitetin personal, sepse individët pajtohen me identitetet sociale që përputhen me atributet e tyre personale. Si rrjedhojë, kur kërcënohet identiteti social, identiteti personal kërcënohet edhe së brendshmi. Gjithashtu, kjo mund të sjellë shfaqjen e zemërimit. Rrjedhimisht, nëse dikush identifikohet me një ideologji radikale ose me grupe luftëtarësh të huaj, vlerat dhe besimet e përbashkëta mund ta shtyjnë individin të sillet njësoj si grupi i tij/saj i identitetit. Sapo përforcohet, identiteti i grupit bëhet po aq i rëndësishëm sa identiteti personal.

Një nga shqetësimet më të mëdha që shprehin institucionet e sigurisë, ishte mënyra se si e identifikonin veten individët që dyshoheshin për ideologji radikale. Një përfaqësues i policimit në komunitet në Tiranë u shpreh: “Unë mendoj se kemi të bëjmë me një problem themelor kur dikush që jeton në këtë vend e konsideron veten fillimisht mysliman dhe më pas shqiptar... kjo e bën ta vendosë fenë pararegullave dhe ligjeve të shoqërisë” (Oficerët e Policimit në Komunitet, Tiranë 2018). Një pikëpamje e ngjashme u nda edhe nga një tjetër oficer në Kavajë, i cili nënkuptonte se format radikale të identifikimit mund të shpien drejt sjelljeve të paqytetëruara, dhe deklaroi “e çfarë mund të prisni nga një burrë që braktis gruan dhe fëmijët e tij, pasi mendon se nuk janë aq të rëndësishëm sa detyra e tij ndaj Zotit (Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet, Kavajë 2018).” Megjithatë shumë prej këtyre deklaratave përmbajnë paragjykime personale, një nga faktorët që institucionet e sigurisë e konsiderojnë të rëndësishëm është shkëputja nga vlerat qytetare dhe normat shoqërore tipike. Në këtë aspekt, imami në Kavajë deklaroi se për shkak të mësimave dhe dogmës fetare, shndërrimi në një luftëtar të huaj lidhet kryesisht me besimet e atij personi për shkak se: “një besimtar do të rrezikonte jetën e tij vetëm nëse beson krejtësisht se ajo që ai mbështet po kërcënohet; përveçse nëse jeni mercenar, dhe në këtë rast ju mund ta bëni për para” (Imami në Kavajë, 2018).

Formimi i identitetit është pjesë përbërëse e kohezionit në grup dhe kjo është arsye madhore se përse identiteti i grupit theksohet në mjediset radikale. Punonjësit e policisë në të dyja zonat periferike të Tiranës deklaruan se shpesh individët identifikohen kaq shumë me *xhematet*, sa që pjesa më e madhe e jetës së tyre të përditshme lidhet me veprimtarinë e xhamisë, nga e cila ata fillojnë gradualisht të tërheqin familjet, të krijojnë rrethe shoqërore për familjet e tyre dhe të vetizohen nga shoqëria e gjerë. Shefi i Policisë së Yzberishtit (zonë periferike e Tiranës) e sheh këtë si shenjën e parë të dukshme të radikalizimit dhe cenueshmërisë së komunitetit, dhe deklaroi se “nëse dikush vetizohet nga pjesa tjetër e shoqërisë, dhe fillon të ndihet më afër me dikë që e ka 1000 kilometra larg, ky individ është gati t’i bashkohet atij grupi nëse shfaqet mundësia. Dhe, sigurisht që ata përbëjnë rrezik për shoqërinë” (Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet, Tiranë 2018). Megjithatë, është e rëndësishme të kemi parasysh se forcat e sigurisë kanë pasur prirjen të anojnë më shumë drejt ‘kornizave të sigurisë’ së problemit.

Identiteti fetar u shfaq më i fortë në Kavajë, dhe më pak në Tiranë dhe Korçë. Në krahasim me perceptimet (me shumë gjasa krijim i stereotipave) e institucioneve të sigurisë, vetëm identiteti fetar nuk është tregues i cenueshmërisë, pasi në fakt Kavaja ka nivelet më të ulëta të EDH-së. Për më tepër, sipas myftiut të Kavajës, shumë qytetarë ishin “të vetëdijshëm dhe shumë të ndjeshëm ndaj persekutimit, fatkeqësive njerëzore, dhe padrejtësisë së përgjithshme që po ndodh në Siri... dhe se padrejtësitë nuk mund të zgjidhen individualisht, ndaj ne u siguroam që ta përcjellim mesazhin me sukses” (Myftiu i Kavajës, 2018). (Mesa duket, veprimet e komunitetit fetar këtu ishin thelbësore për qëndresën, në vend të ekzistencës së një ideologjie, që në një pikë të caktuar shndërrohet në kërcënim.)

Në Korçë, krahas identifikimit ndër-fetar (mysliman ose ortodoks), praktikantët e Islamit identifikohen edhe me fraksione brenda komunitetit mysliman; kjo formë brendafetare e identifikimit i atribuohet pajtimit me shkollat të ndryshme të Islamit. Dallimet në identitet ndërmjet grupeve të ndryshme fetare kanë sjellë zhvillimin e stereotipave, madje edhe akte të izoluar të dhunës ndër-fetare. Në rastin e parë, në një FG të ngritur me praktikante myslimane në Korçë, pjesëmarrësit vëzhguan stereotipa nga popullata e moshuar, që janë rritur pa praninë e besimit fetar gjatë periudhës komuniste, si dhe në punën e tyre dhe në institucione. (Praktikante myslimane në Korçë, 2018). Një vajzë pretendonte se ndihej e diskriminuar, sepse nuk mund ta praktikonte fenë e saj në vendin e punës, ndërsa një tjetër besonte se mësuesi ortodoks e kishte ngelur në klasë për shkak se ajo ishte myslimane (po aty). Pjesëmarrësit konfirmuan se këto raste të krijimit të stereotipave për praktikantët, ritualet dhe veshjen janë mjaft sporadike, por megjithatë janë të pranishme. Udhëheqësit fetarë kanë mendimin se “pikëpamjet gjyqësore janë

të pranishme, por nuk ka shenja të dukshme të diskriminimit”, dhe si rrjedhojë, kanë pak ndikim në komunitetin mysliman (Imam në Korçë, 2018).

Nga ana tjetër, dallimet brenda fesë lindin kryesisht për shkak të çështjeve të përfaqësimit brenda myftinisë (organi administrativ i komunitetit mysliman në një zonë të caktuar). Një imam deklaroi se “ka pasur disa pretendime për ndarjen e pushtetit... Megjithatë, kur iu jepet mundësia për të ushtruar veprimtaritë e tyre fetare sipas preferencave të tyre, tensionet ulen” (po aty). Sërish, në të dyja rastet, identiteti mund të shërbejë si motivim për dallimet themelore; megjithatë, arsyet themelore për ekstremizmin janë të ndërlidhura. Në këtë aspekt, Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet në Korçë besonte se vandalizimi i simboleve ortodokse, pavarësisht se u cilësua si incident fetar, ishte para së gjithash një akt kriminal i kryer nga individë që veprojnë më shumë si një bandë kriminale (Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet, Korçë 2018).

Në Tiranë, grupi radikal përgjegjës për rekrutimin e mbi 70 individëve për të marrë pjesë në konfliktin në Siri kishte ndjenjë shumë të fortë të identitetit të grupit. Grupi ishte relativisht i vogël dhe për shkak të besimeve të tyre fetare jotradicionale ishte i izoluar nga pjesa tjetër e komunitetit qytetar dhe praktikantët e tjerë të Islamit. Sipas myftiut të Tiranës, metodat uahabiste të predikimit ishin “në kundërshtim me traditën e vjetër shekullore të praktikimit të Islamit në Shqipëri, dhe si rrjedhojë ky grup është ‘i vetizoluar (Myftiu i Tiranës, 2018)’. Ka shumë rëndësi të theksojmë se megjithëse ideologjia radikale është faktor i rëndësishëm në shfaqjen e zemërimit, është izolimi nga pjesa tjetër e shoqërisë që ndihmoi në nxitjen e radikalizmit dhe në mbrojtjen e grupit radikal nga ndërhyrja shoqërore.

*b) Edukimi i përgjithshëm dhe fetar jo i duhur ose mungesa e tij* – Ndër të tjera, imamët e lidhin numrin e mëparshëm të LH-ve të Shqipërisë me “mungesën e njohjes së duhur fetare” (Praktikantë myslimanë në Kavajë, 2018). Në fakt, ky faktor shfaqet gjatë gjithë punës në terren, edhe pse pjesërisht për shkak se të intervistuarit ndienin nevojën të distancoheshin nga aktet e dikujt që cenonte sistemin e tyre të besimit personal. Nga ana tjetër, ky mendim u nda edhe nga drejtuesit e institucioneve dhe pjesëmarrësit në FG. Në thelb, ky mund të jetë keqinformim për fenë dhe i atribuohet një gabimi të paqëllimshëm. Megjithatë, në shumicën e rasteve ka një propagandë ndjekjeje, madje edhe keqinformim që sjell radikalizimin e mëtejshëm. Udhëheqësit fetarë pretendojnë se “nuk ka kërcënim real të një ekstremizmi me motive fetare në Shqipëri” (Imam në Korçë, 2018) dhe se fatkeqësisht, “shumë persona janë keqinformuar për kuptimin e vërtetë të fesë, që po përdoret nga grupet terroriste për qëllimet e tyre” (Imam në Tiranë, 2018). Megjithatë, sipas myftiut të Tiranës, mungesa e edukimit të përgjithshëm për seriozitetin e fenomenit është një tjetër problem që duhet trajtuar (Myftiu i Tiranës, 2018). Ky edukim duhet të përfshijë fushata ndërgjegjësuese, duke targetuar të gjithë komunitetin fetar me qëllim që shoqëria të shmangë portretizimin e tij krejtësisht si një problem i myslimanëve, dhe të njohë motivet e vërteta themelore. Kjo pikëpamje u nda njëzëri nga të gjitha burimet kyçe dhe anëtarët e FG-ve.

Në rastet studimore në Tiranë dhe Korçë, njerëzit ishin pak të informuar për fenë (besimtarë ose jo). Në një rast, specialisti i policimit në komunitet nga Tirana deklaroi se “shumë djem të rinj nuk dinë asgjë për fenë, janë të hutuar me gjithë këtë informacion që marrin... sapo dëgjojnë diçka priren menjëherë që ta besojnë” (Oficerë të Policimit në Komunitet, Tiranë 2018). Shqetësime të ngjashme u ndanë edhe nga imamët në Tiranë, Korçë dhe Kavajë. “Keqinterpretimi i misionit të Islamit” ose “mungesa e njohjes së duhur” duket se është një vlerësim i përbashkët ndërmjet udhëheqësve fetarë të të gjitha komuniteteve.<sup>121</sup> Imamët në Tiranë dhe Korçë deklaruan se të gjithë e kishin trajtuar çështjen me praktikantët në xhamitë e tyre; megjithatë, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për çdo xhami në bashki, që është arsyeja se përse ky fenomen u përqendrua vetëm në komunitete të veçanta. Myftiu i Tiranës deklaroi se xhamitë ishin plotësisht të izoluara dhe praktikonin Islamin jashtë mbulimit të KMSH-së, dhe si rrjedhojë ishte e vështirë të vërtetohej nëse ata po predikonin mësimin e duhur.

Nga ana tjetër, Bashkia e Kavajës dukej se e kishte trajtuar çështjen që prej fillimit të fenomenit të LH-së, si në nivel qendror edhe në nivel komunitar. Myftiu i Kavajës deklaroi se sapo e kuptoi se fenomeni mund të shkaktonte probleme në komunitetin e tij, “organizoi një mbledhje me imamët për t’u siguruar se përcjellim mesazhet e duhura” kundër ideologjive radikale (Myftiu i Kavajës, 2018). Kjo deklaratë u pohua edhe nga praktikantët në një FG, të cilët e përmendin “punën pozitive të imamëve që nga fillimi” si faktor kontribues ndaj qëndresës së qytetit (Praktikantë myslimanë në Kavajë, 2018). Ajo

<sup>12</sup> Këto pikëpamje u ndanë gjatë intervistave me imamët e Tiranës, Korçës dhe Kavajës.

çfarë vihet re në rastin e Kavajës është natyra proaktive e angazhimit dhe koordinimit ndërmjet udhëheqjes qendrore dhe imamëve që punojnë në terren.

Aktorët që kontribuojnë ndjeshëm në këtë keqinformim janë kryesisht individët që edhe vetë nuk e njohin siç duhet Islamit, ose që pajtohen me një version radikal të fesë. “Kontakti i drejtpërdrejtë” është forma parësore e indoktrinimit. Në një FG me praktikantët në Tiranë, një nga pjesëmarrësit (që ishte një i njohur i imamit përgjegjës për rekrutimin e disa LH-ve) deklaroi se shumë njerëz e marrin indoktrinimin e tyre të parë nga kontakti i drejtpërdrejtë, dhe shumica e atyre që u larguan për të luftuar në Siri në fakt kishin shumë pak njohuri për fenë (Praktikantë myslimanë në Tiranë, 2018). Kjo u konfirmua edhe nga punonjësit e policisë në Tiranë dhe Korçë, të cilët e përshkruan si “shoqërim me personat e gabuar, personat që kanë prirje radikale dhe që realisht nuk dinë asgjë për fenë” (Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet, Tiranë 2018), si dhe nga myftiu i Tiranës, që theksoi “kontaktin fizik të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm” (Myftiu i Tiranës, 2018).

c) *Keqinformimi* – Ky përfaqëson një përpjekje të qëllimshme për të keqorientuar apo për të shpërndarë “informacione të rreme që synojnë keqorientimin” (Kumar dhe Geethakumari, 2014, 3). Në rastin e radikalizimit në Shqipëri, aktet e keqinformimit shfaqen në shumë forma, duke përfshirë shtrembërimin e fakteve, refuzimin e kritikave, dhe shpërqendrimin e vëmendjes e devijimin në çështje të tjera. Megjithëse pjesa më e madhe e subjekteve të punës në terren nuk kishin dijeni për format e diskriminimit, ata pa e ditur po përshkruanin karakteristikat e tij. Për shembull, për sa i përket shtrembërimit të fakteve, një punonjës policie në Tiranë shpjegoi se si të rinjtë pyesin vazhdimisht për luftërat në Lindjen e Mesme, dhe kanë prirjen të besojnë se ato ishin luftëra kundër myslimanëve; përfaqësuesi i policisë shpjegoi se “ata thonë që do të shkojnë në luftë sepse myslimanët po vriten nga njerëz që nuk besojnë në Zot” (Oficerët e Policimit në Komunitet, Tiranë 2018). Në FG-të e organizuara në Korçë dhe Kavajë, shpesh praktikantët pohojnë se “[me shumë gjasa individët e radikalizuar] nuk e kuptojnë se po mashtrohen”, duke iu referuar sërish shtrembërimit të fakteve. Për më tepër, myftiu i Tiranës pohoi se shumë individë që nuk e njohin shumë mirë fenë, “nuk e kuptojnë se ku po përfshihen, pasi ata priren t’i besojnë propagandës së fshehur [organizatat terroriste], që i premtan gjëra që nuk do të ndodhin kurrë” (Myftiu i Tiranës, 2018). Në Korçë, mësuesit ishin shumë të shqetësuar se mbledhjet e krishtera në komunitete të vogla po luanin një rol të madh në tërheqjen e vëmendjes së fëmijëve të vegjël të cenusëshëm ndaj ideologjive që jo domosdoshmërisht edukojnë vlerat qytetare, ata e shohin këtë si kërcënim ndaj kohezionit social në të ardhmen (Përfaqësues të shoqërisë civile në Korçë, 2018).

Të gjithë imamët ranë dakord se “pjesa më e madhe e këtij informacioni [duke nënkuptuar atë radikal] nuk merret nga autoritetet fetare, por individët binden vetë”<sup>14</sup> dhe media online ka rolin e saj madhor për të luajtur në këtë pikë. Udhëheqësit fetarë ranë që të gjithë dakord se ka shumë keqinformime për fenë, çka po dëmton imazhin e Islamit. Një punonjës policie në Tiranë, që identifikohet si praktikant, pohoi se “ajo që ne kemi parë nuk është Islami i vërtetë; Islami është ‘rrëmbyer’ nga terroristët për t’u përdorur për përfitime politike” (Oficerë të Policimit në Komunitet, Tiranë 2018). Nga ana tjetër, drejtuesit vendorë (përfaqësues të bashkisë) janë të ndërgjegjshëm se keqinformimi përbën problem, por ata nuk janë shumë të përfshirë në problemin e EDH-së. Kërcënimin nga EDH-ja nuk është problem që përsëritet, dhe si rrjedhojë qasja bazë e ndjekur duket se është “kjo nuk është problem derisa të bëhet problem” (Përfaqësues i Bashkisë së Korçës, 2018).

Për krahasim, megjithëse keqinformimi nëpërmjet medias online i ka prekur të tria bashkitë, kontaktet e drejtpërdrejta me predikuesit radikalë ndryshojnë. Tirana ka pasur më shumë raste të predikuesve ekstremistë, të cilët e shfrytëzuan izolimin e komuniteteve të veçanta ku predikonin. Nga ana tjetër, në Korçë i vetmi grup ekstremist i identifikuar duket se ka shfrytëzuar mungesën e bashkimit brenda grupeve islamike kryesore të qytetit, dhe e përdori këtë për të predikuar “një version të shtrembëruar të Islamit” (Myftiu i Korçës, 2018). Për një periudhë të gjatë kohore, veprimet e tyre nuk u kritikuan, çka mundësoi shfrytëzimin e ideologjisë nga ana e tyre. Megjithatë, siç pohon edhe shefi i policimit në komunitet, strukturat zyrtare fetare filluan të bashkëpunojnë me policinë për t’i dhënë fund veprimtarisë së këtij grupi. Ndryshe nga dy qytetet e tjera, Kavaja duket se ka mungesë të elementit më të rëndësishëm të radikalizimit, që është kontakti i drejtpërdrejtë me individët radikalë. Në këtë aspekt, myftiu i qytetit dhe shefi i policimit në komunitet ranë dakord se udhëheqësit fetarë kanë luajtur rol pozitiv në raportimin dhe trajtimin e çështjeve të radikalizimit.<sup>15</sup>

<sup>14</sup> Këto pikëpamje u ndanë gjatë intervistave me përfaqësuesit e KMSH-së (imamët dhe myftinjët) në Tiranë, Korçë dhe Kavajë.

<sup>15</sup> Këto pikëpamje u ndanë gjatë intervistave me myftiun dhe shefin e sektorit të policimit në komunitet në Kavajë

d) *Radikalizimi në internet* – Shumë pjesëmarrës në FG dhe të intervistuar besonin se media sociale ofron një mundësi të rrezikshme për vetëradikalizim, veçanërisht për të rinjtë. Si rrjedhojë, është e rëndësishme që komunitetet të punojnë së bashku për edukimin dhe ndërgjegjësimin lidhur me rreziqet e platformave online. Megjithatë vlerësimi i radikalizimit në internet është i vështirë, shumë informues kyç, si dhe aktivistë dhe drejtues të komunitetit, që morën pjesë në fokus grupe, ishin të sigurtë se media online ka një ndikim të madh të rinjtë. Për më tepër, ajo luan rolin e një katalizatori për shtimin e ritmit të radikalizimit, dhe të një mekanizmi për të vendosur kontakte me përfaqësuesit e ideologjisë së EDH-së. Një udhëheqës fetar deklaroi se “nëpërmjet medias online, të rinjtë marrin përgjigje shumë të thjeshta dhe bindëse për paragjykimet e tyre paraekzistuese, të cilat zakonisht mbeten të pakundërshtueshme” (Imam në Korçë, 2018). Shqetësime u ngritën pothuajse në të gjitha FG-të dhe veçanërisht nga pjesëmarrës që punojnë si mësues ose me komunitetet e cenushme. Shqetësimet e tyre të veçanta lidheshin me faktin se prindërit nuk e monitorojnë ekspozimin e fëmijëve të tyre në mediat sociale, dhe kur kjo gjë gërshetohet edhe me izolimin dhe mënjanimin social, radikalizimi mund të ndodhë pa u zbuluar.<sup>16</sup>

Radikalizimi në internet shfaqet si problem në të gjitha bashkitë, dhe është e vështirë që të bëhet vlerësimi i tij aty ku mund të ketë pasur ndikimin më të madh. Fatkeqësisht, asnjë nga komunitetet nuk i ka kapacitetet për të zbuluar apo për të ndërprerë radikalizimin në internet, dhe kjo është arsyeja përse pothuajse në të gjitha komunitetet, pjesëmarrësit e studimit në terren e shihnin atë si kërcënues, veçanërisht kur informacioni për fenë “shërbehej pa filtra” (Myftiu i Tiranës, 2018). Një shqetësim madhor për median sociale është pamundësia për të kontrolluar shpërndarjen e narrativave. Sipas shefit të policimit në komunitet në Kavajë, “është e vështirë që të kontrollohet media sociale në veçanti, e cila mund të kontribuojë në forcimin e besimeve radikale, që mund të pasqyrohen në të ardhmen nëse individët i mbajnë përbrenda” (Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet, Kavajë 2018). Megjithatë, mendimet për ndikimet e medias sociale ndryshojnë, çka tregon se shumë nga vetë aktorët kanë fare pak njohuri për ndikimin e vërtetë. Për shembull, pavarësisht se një imam në Korçë pohoi se media sociale kryesisht promovon narrativën islamofobike, dy imamë në Tiranë kishin këndvështrime të kundërta lidhur me mënyrën se si ndikon media sociale te praktikantët, ku njëri prej tyre besonte se ajo kishte një ndikim të papërfillshëm, ndërsa tjetri besonte se mund të kishte “pasoja serioze nëse nuk trajtohej si duhej nga imamët.”<sup>17</sup> Mendime të ndryshme u ndanë edhe nga pjesëmarrësit në FG, ku disa pjesëmarrës përmendën internetin si një “formë të rëndësishme të shpërndarjes së ideologjisë ekstremiste”, ndërsa të tjerët e shihnin atë si një “katalizator” për t’u informuar për ideologjinë e mbështetur më parë.<sup>18</sup> Kjo tregon se për shkak të vështirësive në vlerësimin e ndikimit të radikalizimit në internet, mendimet për të nuk bazohen në vëzhgime konkrete, por në perceptime. Për sa i përket këtij faktori në veçanti, është e vështirë të përcaktohet se cili komunitet është më i cenushtë apo më i qëndrueshëm, pasi mesa duket pothuajse të gjitha komunitetet kanë pak njohje për shkallën dhe ndikimin e radikalizimit në internet.

### *Faktorët ideologjikë të qëndresës*

Përveç faktorëve të cenushtëmërisë, disa nga aktorët dhe faktorët ideologjikë që luajnë rol pozitiv në rritjen e qëndresës së komunitetit ndaj EDH-së përfshijnë:

e) *Vlerat e shëndosha qytetare* – Një temë e rëndësishme gjatë studimit në terren ishte ideja se nxitja e vlerave qytetare ose respektimi i diversitetit dhe tolerancës fetare mund të shërbejnë si një mekanizëm vendimtar për parandalimin e diskriminimit, mënjanimin dhe ideologji radikale. Kur u pyetën “Si mund të parandalohet EDH-ja në të ardhmen?”, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në FG dhe të intervistuarit evidentuan parimet lidhur me vlerat qytetare, si: “nxitja e tolerancës dhe mirëkuptimit” (Përfaqësues nga Bashkia e Tiranës, 2018), “ndërgjegjësimi i njerëzve se edhe ata kanë përgjegjësi si qytetarë” (Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet, Tiranë 2018), dhe “nxitja e respektit për njëri-tjetrin dhe për fenë e tyre” (Përfaqësues nga shoqëria civile, Tiranë 2018). Vlen të theksojmë se pothuajse të gjithë pjesëmarrësit ranë dakord në parim për nxitjen e vlerave të shëndosha qytetare; megjithatë, ende nuk ka asnjë projekt veprimi për zbatimin e këtyre nismave.<sup>2</sup>

<sup>16</sup> Këto pikëpamje u ndanë gjatë FG-ve në Korçë dhe Kavajë.

<sup>17</sup> Këto pikëpamje u ndanë gjatë intervistave me imamët në Tiranë dhe Korçë.

<sup>18</sup> Këto pikëpamje u ndanë gjatë FG-ve në Tiranë dhe Kavajë.

*f) Edukimi fetar për të ndërgjegjësuar* – Për të plotësuar këto përpjekje, si sekretari i Bashkisë së Kavajës

edhe Shefi i Policimit në Komunitet pohuan se fushatat edukuese në komunitetin e tyre të vogël kanë qenë të dobishme në të shkuarën, dhe ata mendonin se ishte e rëndësishme të informonin sa më shumë aktorë që të ishte e mundur për rreziqet dhe kërcënimin e EDH-së.<sup>19</sup>

Sipas një administratori të pushtetit vendor në Tiranë, “më shumë vëmendje i duhet kushtuar edukimit të të rinjve”. Kjo pikëpamje u nda edhe nga shumë pjesëmarrës në studim, por ajo që u dallua ishte përpjekja e mësuesve të shkollave në Korçë dhe Kavajë për ta trajtuar fenomenin në klasat e tyre. Në të dyja rastet, pjesëmarrësit që punonin si mësues të shkollave të mesme raportuan se e kishin ngritur këtë problem, por shtuan se nevojitet një qasje institucionale më e strukturuar.<sup>20</sup> Një praktikante nga Korça pretendonte se “ekstremizmi është mbajtur në kontroll për shkak të mësimeve të duhura nga imamët” (Praktikante myslimane në Korçë, 2018). Për sa i përket ndërgjegjësisimit, shumica e përpjekjeve janë përqendruar në komunitetin fetar, pasi në disa raste drejtuesit e pushtetit vendor nuk kishin dijeni për nisma të rëndësishme, si Plani i Veprimit dhe Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (Këshilli i Ministrave, 2015). Të gjithë udhëheqësit fetarë raportuan se i kishin trajtuar problemet lidhur me EDH-në brenda kongregacionit të tyre. Një tjetër sugjerim në fushën e edukimit që u dha nga pjesëmarrësit në studimin në terren ishte futja e lëndës së “edukimit fetar” në shkolla nga specialistë fetarë të trajnuar, si një mekanizëm për frenimin e keqinformimit dhe uljen e cenueshmërisë së të rinjve ndaj ekstremizmit fetar.<sup>21</sup> Është e vështirë të parashikohet nëse kjo alternativë do të mund të realizohet apo do të jetë efiçase, por shumë udhëheqës fetarë folën në favor të kësaj nisme.

*g) Kultura dhe tradita e përbashkët* – Në këtë kontekst, termi ‘kulturë’ është pothuajse sinonim me termin ‘traditë’. Një nga elementet dalluese midis përgjigjeve të dhëna në Kavajë, Korçë dhe Tiranë ishte shkalla e vëmendjes që i kushtohet kulturës dhe traditës, dhe se si interpretohej ajo në secilin kontekst. Për shembull, pothuajse çdo burim në Kavajë theksoi “harmoninë ndërpersonale, që ka qenë historikisht veçori e komunitetit (Përfaqësues nga Bashkia e Korçës, 2018). Sipas shumë pjesëmarrësve në studim, një pjesë e rëndësishme e kulturës së Kavajës ka qenë edhe “lidhja e fortë me njëri-tjetrin”, që është shfaqur nëpërmjet festimeve të përbashkëta fetare në shenjë solidariteti, vizitave tradicionale gjatë rasteve shoqërore, martesave ndërfaqetare, dhe miqësive.<sup>22</sup> Një situatë e ngjashme mund të vihet re edhe në Korçë, por pjesëmarrësit në studim e interpretuan situatën më shumë si një gjendje neutrale të bashkëjetesës sesa si një situatë ku komuniteti në mënyrë aktive kërkon vendosjen e lidhjeve dhe marrëdhënieve. Nga ana tjetër, në Tiranë, megjithëse traditat e respektit reciprok shihen si të rëndësishme, shumë komunitete duhet ende që të zhvillojnë ‘kulturën e përbashkët’, duke pasur parasysh se ato janë formuar së fundmi dhe ndërveprimi është i kufizuar.

### 3.3.2 Faktorët socio-ekonomikë

*a) Mënjanimi, marginalizimi, izolimi dhe diskriminimi* – Këta faktorë janë të lidhur ngushtë me problemet e përgjithshme socio-ekonomike. Privimi ekonomik dhe izolimi formojnë një rreth vicioz që e vështirëson edhe më shumë daljen e individëve prej tij. Në këtë kontekst, madje edhe nëse individët nuk identifikohen me EDH-në, dëshira ‘për t’u arratisur’ nga realiteti i tyre i marginalizimit mund ta kapërcejë frikën e rreziqeve lidhur me përfshirjen në EDH. Kjo u shpreh nga të intervistuarit në deklaratat e tyre, ku pohonin se “kur nuk keni mjaftueshëm para për të ushqyer familjen tuaj, nuk mund ta mbani kokën lart” (Përfaqësues të shoqërisë civile në Kavajë, 2018). Megjithatë, izolimi mund të ndodhë edhe për shkak të diskriminimit në nivel të moderuar bazuar në besimin fetar. Megjithëse ky diskriminim nuk është qartësisht i dukshëm, pasi shumë shqiptarë qëndrojnë tolerantë ndaj grupimeve të tjera fetare, disa praktikantë kanë pohuar se ndiejnë disa forma jo të përhapura të diskriminimit. Kjo ndjesi u nda edhe nga disa praktikantë, që ishin pjesë e FG-ve, ndërsa njëri prej tyre pohoi se “është e vështirë të mos ndihesh i izoluar kur gjykoheni për besimin tuaj personal, dhe thjesht nuk doni të keni përplasje; në teori, gjithsecili thotë se e respekton zgjedhjen tuaj, por në realitet ka njëfarë stigme kundër besimit tuaj” (Praktikantë myslimanë në Kavajë, 2018).

<sup>19</sup> Këto pikëpamje u ndanë gjatë intervistave me shefin e policimit në komunitet dhe me përfaqësuesin e Bashkisë së Kavajës.

<sup>20</sup> Këto pikëpamje u ndanë gjatë FG-ve në Korçë dhe Kavajë.

<sup>21</sup> Të gjithë udhëheqësit fetarë të intervistuar (në një formë apo në një tjetër) e përshëndetën idenë e futjes së edukimit fetar në shkolla.

<sup>22</sup> Këto pikëpamje u ndanë gjatë FG-ve me shoqërinë civile dhe me praktikantë myslimanë në Kavajë.

Qartazi, ka ndryshime në shkallën e marginalizimit, diskriminimit dhe veçimit të shprehur ndërmjet komuniteteve të përzgjedhura. Anëtarët e komunitetit në Kavajë duken shumë të lidhur me njëri-tjetrin. Sipas fjalëve të një imami të asaj zone, “të gjithë [aty] e njohin njëri-tjetrin, dhe kanë hyrjedalje me njëri-tjetrin” (Imam në Kavajë, 2018), duke nënkuptuar lidhje të forta ndërpersonale. Pikëpamje të ngjashme u ndanë edhe nga një praktikante, që ishte konvertuar në myslimane, e cila deklaroi se ndihej më e pranuar në Kavajë sesa në vendlindjen e saj në Kukës (Praktikantë myslimanë në Kavajë, 2018). Pjesëmarrësit në Kavajë pranuan se rastet e diskriminimit janë të pranishme; megjithatë, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit pohuan se nuk ndiheshin të diskriminuar. Një praktikante myslimane, e cila ishte mësuese, pohoi se në më të shumtën e rasteve “na bënin pyetje tendencioze se përse vishnim hixhab, por kjo gjë nuk na shqetëson më tani” (Praktikantë myslimanë në Kavajë, 2018).

Përkundrazi, në Korçë pjesëmarrësit shprehën pikëpamje kundërshtuese. Nga ana tjetër, përfaqësuesja e pushtetit vendor besonte se ndërmjet komuniteteve fetare ka respekt të ndërsjelltë, por ajo pranoi se mund të ketë disa raste diskriminimi të paqëllimshme kur bëhet fjalë për punësimin e punonjësve të bashkisë (pjesa dërrmuese e të cilëve janë të krishterë ortodoksë) (Përfaqësues nga Bashkia e Korçës, 2018). Megjithatë, praktikantët përshkruajnë një situatë të ndryshme, që tregon shenja të diskriminimit brendafetar dhe ndërfetar. Praktikantët pohuan se shumë njerëzve nuk iu pëlqen mënyra se si ato vishen, dhe se ka shumë pak myslimanë që punojnë në institucione shtetërore, dhe në një rast, eprori i një pjesëmarrëseje organizoi një anketim për të parë nëse njerëzit ishin dakord për veshjen e hixhabit (Praktikante myslimane në Korçë, 2018). Si për ironi, kur u pyetën për komunitetin tjetër mysliman në Korçë, atë bektashi, këto praktikante pohuan se “Bektashinjtë nuk kanë lidhje me Islamin” (po aty). Së fundi, Tirana është përzierje e shumë feve dhe kulturave vendore për shkak të migrimit të brendshëm gjatë 25 viteve të shkuara. Si rrjedhojë, shumë komunitete të krijuara së fundmi, veçanërisht në periferi, kanë pak të përbashkëta. Shefi i policimit në komunitet për zonën e Yzberishtit pohoi se “problemet sociale, ekonomike dhe ndonjëherë edhe paafësia për t’u përshtatur me komunitetin e ri i izolon më shumë njerëzit... sigurisht që kjo i bën individët të pakënaqur” (Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet, Tiranë 2018).

*b) Privimi ekonomik dhe mungesa e mundësive* – Mesa duket, aspekti ekonomik është një tjetër faktor që rrit cenueshmërinë nga EDH-ja. Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit në FG dhe të intervistuarit e vunë theksin te ky faktor. Kur u pyetën për arsyet se përse dikush mund të bëhet radikal, përgjigja e zakonshme ishte për shkak të papunësisë dhe vështirësive financiare. Privimi ekonomik ia bën të vështirë individëve ruajtjen e lidhjes së tyre me shoqërinë, dhe akoma edhe më të vështirë sigurimin e jetesës. Për më tepër, mungesa e vazhdueshme e mundësive ekonomike sjell zemërim dhe humbjen e shpresës (Myftiu i Korçës, 2018). Kur ndodh diçka e tillë, individët kanë më shumë gjasa të përfshihen në veprimtari të rrezikshme, si ekstremizmi i dhunshëm, për aq kohë sa paguhen. Megjithatë, ia vlen të theksojmë se komuniteti më pak i prekur (Kavaja) është edhe një nga komunitetet me shkallën më të lartë të papunësisë, me të ardhurat më të ulëta dhe me mundësi të kufizuara për shkak të kufizimeve gjeografike; ajo ndiqet nga Korça dhe më pas nga Tirana. Ky fakt është i rëndësishëm pasi tregon se vështirësitë ekonomike mund të jenë një faktor kontribues, por nuk janë domosdoshmërisht çelësi, i vetmi faktor që e shtyn individin drejt EDH-së. Një nga shefat e policimit në komunitet në Tiranë e shpjegoi këtë duke e ndarë procesin në dy faza, duke pohuar se: “nxitësit drejt radikalizimit janë të ndryshëm, duke përfshirë edhe vështirësitë ekonomike, por faktori nxitës që qëndron pas vendimit për të rrëmbyer armët dhe për t’u angazhuar në ekstremizmin e dhunshëm është faktori ideologjik” (Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet në Tiranë, 2018). Kjo thekson se prekshmëria nga EDH-ja varet nga dinamikat e ndërveprimit dhe kombinimi i faktorëve të cenueshmërisë.

*c) Mundësimi i rrjeteve sociale* – Rrjetet sociale kontribuojnë në lehtësimin e rrugës drejt radikalizimit. Ato mund të shihen si rrugët drejt radikalizimit dhe EDH-së. Rrjetet sociale kanë ndikimin më të madh në komunitetet më të izoluara që përballen me vështirësi ekonomike, duke përfshirë papunësinë, varfërinë dhe nënzhvillimin. Sipas shefit të rajonit të policisë në Tiranë, rrjetet sociale mund të kenë një ndikim të madh veçanërisht nëse individët janë të papunë dhe shohin pak shpresë për të ardhmen e tyre. Ai shkoi më tej duke thënë se radikalizimi drejt EDH-së është i ngjashëm me atë që ndodh me bandat, duke

pasur parasysh se janë pothuajse identike (Oficerë të Policimit në Komunitet, Tiranë 2018). Shefi i policisë vijoi më tej duke thënë se në rastin e një komuniteti të veçantë në Tiranë (Yzberisht), ku radikalizimi kishte nivelin më të lartë në vend, rrjetet sociale ishin thelbësore për ruajtjen e lidhjeve të vazhdueshme me ideologjinë ekstremiste, për shkak të varësisë së krijuar gradualisht, e cila erdhi nga “ofrimi i ushqimit, veshmbathjeve, parave, dhe strehimit” (po aty). Shefi i policimit në komunitet në Korçë ndau mendimin se rrjetet sociale mund të jenë shtysa të fuqishme. Ai përmendi rastin e një grupi të vogël radikalësh, që vandalizuan monumentet e krishtera në Korçë dhe e konsideroi aktin e tyre kryesisht si kriminal, megjithëse feja ishte përdorur si justifikim (Myftiu i Korçës, 2018). Asnjë pjesëmarrës në studimin në terren në Kavajë nuk mundi të identifikonte asnjë formë të lidhjeve sociale që paraqiste rrezik të lartë për ekstremizëm të dhunshëm.

Aktorët mund të luajnë një rol shumë të fuqishëm në mobilizimin e njerëzve për një ideologji të caktuar përmes rrjeteve sociale. Sipas myftiut të Tiranës, imamët që rekrutuan mbi 70 mbështetës për organizatat terroriste në Siri patën sukses pasi përcollën një mesazh të vazhdueshëm te ndjekësit e tyre, dhe mundën ta bënë këtë njëkohësisht.

### *Faktorët socio-ekonomikë të qëndresës*

Disa nga aktorët dhe faktorët socio-ekonomikë që mund të luajnë rol pozitiv në rritjen e qëndresës së komunitetit ndaj EDH-së përfshijnë:

*d) Lidhjen/kohezionin social* – Megjithëse rrjetet sociale ushtrojnë një ndikim të madh, pasi ofrojnë një ndjenjë përkatësie dhe shoqërimi ndaj individëve, kohezioni social mund të ndihmojë në krijimin e lidhjeve me njerëz të ndryshëm, por që janë pjesë e komunitetit. Njësoj si koncepti i ‘kulturës dhe traditës së përbashkët’, “lidhjet sociale brenda dhe ndërmjet komuniteteve ndihmojnë në zbutjen e faktorëve të rrezikut që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm” (Ellis dhe Abdi, 2017, 290). Koncepti i lidhjeve sociale, siç theksohet shpesh gjatë studimit në terren, për qëllime të këtij raporti duhet kuptuar si marrëdhënie për ndërtimin e raporteve, urave lidhëse dhe lidhjeve brenda dhe ndërmjet komuniteteve dhe/ose institucioneve shtetërore (po aty, 289-300). Raportet shoqërore ndodhin kur individët ndajnë të njëjtin identitet me një komunitet; ndërtimi i urave lidhëse është ndarja e “një ndjenje të përbashkët komunitare” ndërmjet pjesëtarëve të një komuniteti që kanë identitete të ndryshme; dhe lidhja shoqërore iu referohet lidhjeve ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve shtetërore (po aty, 290).

Sa më i ndërlidhur të jetë një komunitet, aq më e madhe është mundësia e krijimit të kohezionit social jo vetëm ndërmjet pjesëtarëve të komunitetit, por edhe ndërmjet strukturave vertikale përmes forcimit të besimit të institucionet. Në këtë aspekt, Kavaja ka filluar zbatimin e programit për ‘policimin në komunitet’, ku institucione të ndryshme bashkëpunojnë për përmirësimin e sigurisë dhe mirëqenies së komunitetit. Gjithashtu, shefi i policimit në komunitet dhe përfaqësuesi i pushtetit vendor pohuan se bashkëpunimi me komunitetin mysliman ka qenë i madh për sa i përket rasteve me rrezik të lartë për radikalizim,<sup>23</sup> që është një shenjë e besimit ndërmjet institucioneve. Në Korçë, shkalla e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor dhe bashkisë arriti deri në krenimin e festave fetare, por nga ana tjetër, pushteti vendor duket më pak i shqetësuar, ndërsa problemi i EDH-së nuk ishte prioritet në politikën e tij (Përfaqësues nga Bashkia e Korçës, 2018). Sipas myftiut të Tiranës, në vitet e fundit është punuar shumë për të dhënë llogari për çdo xhami dhe për t’i vendosur ato nën autoritetin e KMSH-së. Për më tepër, myftinia e Tiranës po punon për ndjekjen e investimeve të huaja për organizata të ndryshme fetare ose xhami, me qëllim parandalimin e një skenari të ngjashëm me atë që ndodhi në Yzberisht (Myftiu i Tiranës, 2018). Pas luftës në Siri, brenda xhamive nuk u krye asnjë donacion i huaj për xhamitë dhe asnjë veprimtari fetare.

*e) Mundësi të barabarta* – Mundësitë e barabarta sociale dhe ekonomike mund të kufizojnë marginalizimin dhe izolimin e një komuniteti, si dhe mund të ofrojnë hapësirë për konkurrencë të ndershme dhe mundësi për arritje. Fatkeqësisht, është e vështirë të bësh dallimin e niveleve të ndryshme të mundësive të barabarta në rastet e përzgjedhura, për shkak se shumë nga faktorët që nxisin mundësitë e barabarta lidhen me politikën në nivel shteti. Megjithatë, aspektet e punësueshmërisë vendore ndryshojnë nga njëri komunitet

<sup>23</sup> Këto pikëpamje u ndanë gjatë intervistave me shefin e policimit në komunitet dhe me përfaqësuesin e pushtetit vendor në Kavajë



te tjetri. Për shembull, në Korçë ka një përfaqësim joproporcional të një grupi fetar në poste qeveritare krahasuar me grupet e tjera. Ndërkohë në Kavajë nuk ndodh kështu.<sup>24</sup> Pavarësisht nëse përgjegjësia për ofrimin e më shumë mundësive të barabarta lidhet me pushtetin qendror apo vendor, e vërteta qëndron që qytetarët në të gjitha komunitetet mendojnë se nuk po përfitojnë mjaftueshëm. Kjo pikëpamje u mbështet në çdo intervistë dhe diskutim në FG, ndërsa “paqëndrueshmëria financiare, pasiguria e individëve për të ardhmen, papunësia dhe vështirësitë ekonomike” u përmendën si faktorë që kontribuojnë në cenueshmërinë nga EDH-ja.

### 3.3.3 Faktorët strukturorë

a) *Perceptimet e qeverisjes së dobët* – Problemi i pasivitetit shtetëror u përmend shpesh si një faktor mundësues, që iu dha mundësinë LH-ve të shkojnë në zonat e konfliktit, si në Siri dhe Irak. Pjesëmarrësit në FG në Korçë ishin të habitur sesi institucionet shtetërore kishin kontroll të kufizuar mbi organizatat që ofrojnë asistencë fetare dhe ekonomike në komunitetet e tyre (Përfaqësues nga shoqëria civile në Korçë 2018). Një pjesëmarrës në FG u shpreh: “Duket sikur [institucioneve qeveritare] nuk u intereson të dinë se fëmijët nuk shkojnë në shkollë vetëm për të ndjekur konkurse këndimi në kisha të paregjistruara” (po aty). Shkëputja që ndiejnë njerëzit me qeverinë jo vetëm që shton zemërimin dhe pakënaqësinë e tyre ndaj shtetit, por edhe i nxit ata që të mos i tremben pasojave në rast të shkeljes së ligjit. Për shembull, një pjesëmarrës në FG-në e Korçës deklaroi se: “askush nuk ishte vërtet i shqetësuar se mund të ndodhte diçka, dukej sikur qeverisë nuk i interesonte shumë, kështu që për disa njerëz kjo ishte pothuajse si një aventurë” (po aty). Perceptime të tilla janë shqetësuese pasi nënkuptojnë se qeveritë nuk veprojnë në mënyrë parandaluese për frenimin e EDH-së, nëpërmjet ndërgjegjësimit ose pranisë së tyre, dhe me shumë gjasë do të vuajnë pasojat dhe do t’iu duhet të reagojnë ndaj pasojave që mund të shkaktojë EDH-ja në komunitetet e tyre.

- I. Moskonsolidimi i pranisë së shtetit – Pjesëmarrësit e punës në terren theksuan se prania e shtetit është vendimtare në parandalimin ose mbrojtjen e individëve nga grupe ekstremiste radikale dhe të dhunshme që duan t’i rekrutojnë. Para së gjithash, pjesëmarrësit kërkuar prani më të madhe të shtetit në komunitetet e tyre, si dhe konsolidimin e pranisë së shtetit në komunitetet e tyre (veçanërisht në zonat rurale dhe malore, që kanë edhe shifrat më të ulëta të investimeve shtetërore). Ata nxorën në pah nevojën për *koordinim* të ndërhyrjeve shtetërore, programimin e tyre dhe përcaktimin e vendndodhjeve ndërmjet aktorëve të ndryshëm (shteti, shoqëria civile ose aktorët fetarë), për *renditje* dhe *sinkronizim* të rendit të ndërhyrjeve (për sigurinë, qytetare, arsimore, ekonomike), dhe për *ndërgjegjësim* lidhur me sfidat me të cilat përballet komuniteti, me qëllim frenimin e komunitetit për t’iu përgjigjur thirrjeve të grupeve ekstremiste. Të gjitha këto sugjerime ishin si përgjigje ndaj perceptimeve të përgjithshme të pritshmërive të paarritura dhe privimit përkatës, nevojave sociale dhe ekonomike të papërmbyshura, lakmisë, ose përhapjes së veprimtarive ekonomike të paligjshme.
- II. Institucione apatike të sigurisë – Sipas shefit të policisë në Tiranë, një nga elementet më të rëndësishme për nxitjen e LH-ve ishte “mungesa e dukshme e interesit të institucioneve shtetërore për të reaguar ndaj situatës [duke iu referuar periudhës kur u shfaq fenomeni i luftëtarëve të huaj]” (Oficerë të Policimit në Komunitet, Tiranë 2018), e cilanxiti veprimet e shumë të tjerëve për ta ndjekur. Shefi i policimit në komunitet në Korçë shprehu një ndjesi të ngjashme dhe shkoi më tej duke thënë se ‘pasiviteti shtetëror’ i perceptuar vjen nga fakti që institucionet shtetërore të sigurisë “nuk e vlerësojnë si duhet nivelin e kërcënimit dhe reagojnë me ngathtësi, gjë që i shtyn shumë njerëz të besojnë se mund të largohen nga vendi për të luftuar në Siri pa vuajtur pasojat” (Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet, Korçë 2018). Një tjetër pikëpamje e ngjashme u nda edhe në diskutimet në një FG në Kavajë, ku pjesëmarrësit ranë dakord se “të gjithë mund të zemërohen kur shikojnë fëmijë që vriten, por shumë pak do të shkonin në Siri nëse do ta dinin se mund të ndaloheshin, dhe në atë kohë, askush nuk po e bënte këtë”.<sup>25</sup>

<sup>24</sup> Në një diskutim në FG me praktikantët, pjesëtarët e komunitetit ortodoks ndiheshin shumë të integruar në jetën socio-ekonomike dhe politike të komunitetit të tyre.

<sup>25</sup> Këto pikëpamje u ndanë gjatë FG-ve me praktikantë myslimanë dhe me përfaqësues të shoqërisë civile në Kavajë

Një tjetër çështje është edhe reagimi nga forcat e policisë, që e shohin rolin e tyre thjesht si agjentë që ndërhyjnë pas kryerjes së veprimit. Pjesa më e madhe e përpjekjeve të tyre përqendrohen në luftën dhe reagimin ndaj kërcënimit, ndërsa parandalimit i kushtohet shumë pak rëndësi. Nga ana tjetër, ka pak bashkëpunim me institucionet e tjera, megjithëse ato vijojnë të monitorojnë në zonën e operimit. Në përgjithësi, imamët besojnë se nevojitet më shumë trajnim për këtë temë, me qëllim që të ndërgjegjësohen më shumë praktikantë për rreziqet e EDH-së (Myftiu i Tiranës, 2018).

- III. Institucione joefikase – Megjithëse të gjitha bashkitë janë shumë të hapura për bashkëpunim me institucione të tjera për programet e PEDH-së, janë vetë ato që nuk po i ndërmarrin hapat proaktivë për uljen e rrezikut të EDH-së në komunitetet e tyre. Shumë drejtues vendorë i tremb ideja e përjetimit të EDH-së në komunitetet e tyre, por ata nuk e shohin veten si partnerët udhëheqës në parandalimin e kësaj ideologjie<sup>26</sup> në të ardhmen. Mesa duket, kjo çështje nuk zë vend të rëndësishëm në axhendën e tyre. Mungesa e interesit në këtë çështje krijon mundësi për përkeqësimin e situatës së radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në komunitet. Një tjetër pakënaqësi e madhe lidhet me dështimin e institucioneve për të ofruar shërbimet e targetuara. Shërbimet ‘bazë’ të identifikuar më shpesh përfshijnë sigurinë, kujdesin shëndetësor, shtetin e së drejtës dhe arsimin. Mospërmbushja e këtyre shërbimeve bazë mund të shkaktojë përkeqësimin e zemërimit dhe distancimin e individëve nga shteti.
- IV. Korrupsioni dhe pandëshkueshmëria – Korrupsioni dhe pakënaqësia ndaj politikave qeveritare u theksuan vazhdimisht gjatë punës në terren. Ky është faktor i cënueshmërisë që mund të nxisë mosangazhimin qytetar dhe apatinë politike; gjithashtu, mund të nxisë edhe ndjenjën e zemërimit moral. Raporti i vitit 2018 i KE-së për Shqipërinë thekson se megjithëse “numri i dënimeve me vendim të prerë i zyrtarëve të nivelit të ulët ose të mesëm është rritur, ato lidhen kryesisht me sistemin gjyqësor”, dhe shkalla e dënimeve me vendim të prerë të zyrtarëve të nivelit të lartë mbetet shumë e ulët. Në të thuhet se “korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vijon të mbetet një problem serioz” (Komisioni Europian, 2018, 21-22). Sa më i korruptuar të perceptohet shteti, aq më të lehtë e kanë grupet ekstremiste të dhunshme për t’u vetëportretizuar si një alternativë e ligjshme.

*b) Tensionet brenda fesë* – Një tjetër pikë grindjeje e rëndësishme, që kontribuon në përhapjen e radikalizmit brenda një institucioni fetar, janë tensionet brenda fesë. Në Shqipëri, autoriteti i vetëm i njohur zyrtarisht i Islamit është KMSH-ja. Megjithatë, grupe të tjera të ndryshme që ndjekin forma alternative të Islamit mendojnë se ato nuk përfaqësohen nga KMSH-ja. Kjo sjell krijimin e fraksioneve ndërmjet klerikëve dhe praktikantëve fetarë. Për shembull, në Korçë, grupi kryesor mysliman jozyrtar dhe përfaqësues zyrtarë të KMSH-së kanë pasur përplasje të ndryshme lidhur me çështjet e përfaqësimit në myftininë e qytetit. Gjatë një periudhe kohore, xhamitë vendore mbajtën dy mbledhje të ndryshme predikimi, ku grupet e praktikantëve predikuan vetëm me imamët që ata mbështesnin (Praktikantë myslimanë në Korçë, 2018). Më në fund, të dyja fraksionet lanë mënjatë dallimet e tyre dhe i zgjidhën qetësisht mosdakordësitë që kishin.

Një tjetër faktor kontribues në tensionet brenda fesë, është niveli i donacioneve të huaja të pakontrolluara. Në Korçë, financimi nga burime të ndryshme donacionesh ka çuar në krijimin e qendrave komunitare paralele dhe strukturave mbështetëse, të cilat kontribuojnë në konsolidimin e ndarjeve ndërmjet fraksioneve të ndryshme (Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet, Korçë 2018). Një situatë e tillë nuk është krijuar kurrë në Kavajë për arsyen e thjeshtë se të gjitha donacionet marrin miratimin e myftiut. Kjo ka ndihmuar në ruajtjen e një shpërndarjeje të baraspeshuar të fondeve të bamirësisë, ka parandaluar zhvillimin e perceptimeve për favorizim dhe i ka kanalizuar fondet aty ku komuniteti fetar e ka parë më të arsyeshme (Myftiu i Kavajës, 2018).

Veçimi i një grupi të veçantë dhe ndjenja e përforcuar e epërsisë së besimit të dikujt janë të dukshme, megjithëse kjo formë e përçarjes është më shumë e fshehur. Ky diskriminim i fjetur ishte me shumë ngjyrimë dhe jo i drejtpërdrejtë; megjithatë, ai ishte i dukshëm në disa raste ndërmjet praktikantëve fetarë. Për shembull, në një FG në Korçë, disa praktikantë përsëritën dhe pohuan se “bektashinjtë [komunitet fetar në Shqipëri] nuk janë myslimanë të vërtetë”, ndërsa deklaratat e një praktikanteje tjetër

<sup>26</sup> Diskutimet me drejtuesit e Bashkisë së Kavajës dhe Tiranës nxorën në pah nevojën për koordinim qoftë nga pushteti qendror, qoftë nga OJF-të.

nuk u diskutua, e cila u shpreh “pas shumë vitesh, ne besojmë se njerëzit do të ndërgjegjësohen dhe do të jenë më pranë Islamit; ata do ta kuptojnë të vërtetën” (Praktikante myslimane në Korçë, 2018). Pothuajse e njëjta ndjesi u shpreh edhe nga një praktikante në Kavajë. Po ashtu, praktikantë të krishterë lanë të kuptohej se feja e tyre është më superiore, pasi sipas tyre “shumë myslimanë duan të shkojnë në kishë dhe të ndjekin kremtimet e krishtera sepse janë më të thjeshta për t’u ndjekur dhe nuk janë shumë të rrepta” (Praktikantë myslimanë në Kavajë, 2018).

Gjithashtu, dallimet në interpretimin e fesë kanë çuar në distancimin e komuniteteve të ndryshme fetare nga ideologjia kryesore e miratuar nga KMSH-ja. Në fakt, sipas një raporti të Komitetit Shtetëror për Kultet, të kryer në vitin 2015, 200 nga 727 xhami funksiononin jashtë standardeve ligjore dhe lejonin predikimin pa dijeninë e KMSH-së (Mejdini, 2015). Nuk është aspak çudi që këto komunitete të izoluar kanë shërbyer edhe si qendra për radikalizmin fetar; KMSH-ja pretendon se ishin veprimtaritë fetare në këto zona të thella që kontribuan në rritjen e nivelit të retorikës ekstremiste dhe në radikalizmin e banorëve vendas (Myftiu i Tiranës, 2018). Vlen të përmendim se në të gjitha intervistat, udhëheqësit e komuniteteve fetare theksuan rëndësinë e KMSH-së për të pasur një kontroll dhe ndikim më të madh, si një mekanizëm për parandalimin e veprimtarive ‘mashtuese’ të ngjashme dhe radikalizmin e mëtejshëm në të ardhmen.

### *Faktorët strukturorë të qëndresës*

Disa nga aktorët dhe faktorët strukturorë që luajnë një rol pozitiv në rritjen e qëndresës së komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm, janë si më poshtë:

c) *Bashkëpunim i shtuar me institucionet.* Kjo është një karakteristikë thelbësore për trajtimin e EDH-së. Reagimet e deritanishme shtetërore janë të kufizuara tek agjencitë ligjzbatuese, kryesisht përmes masave retroaktive dhe shtrënguese. Anëtarët kyç të Komunitetit Mysliman në Tiranë, Korçë dhe Kavajë, të intervistuar për këtë studim, theksuan rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe KMSH-së. Përfaqësuesit e bashkive të këtyre qyteteve pretendonin se nuk janë përfshirë në projektet e krijimit të qëndresës së komunitetit ndaj EDH-së. Ata pohuan se institucionet qendrore duhet të njohin rolin e mundshëm që mund të luajnë bashkitë në forcimin e tolerancës dhe harmonisë fetare. Për sa i përket trajtimit të EDH-së, përfaqësuesit e intervistuar të policisë, administratës vendore dhe komuniteteve fetare, theksuan se duhet të ndiqet një qasje e hershme ndërmjet shumë agjencish, në mënyrë që praktikantët të kenë aftësinë të ndajnë informacione me të gjitha hierarkitë dhe sektorët. Sipas tyre “secili duhet të bëjë detyrën që i takon”, pasi kjo qasje do të ndihmonte në identifikimin e individëve në rrezik, vlerësimin e natyrës dhe shtrirjes së cenueshmërive, zhvillimin e reagimeve të duhura, dhe në garantimin e ndarjes së informacioneve të duhura (Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet, Kavajë 2018).

d) *Angazhimi komunitar:* aftësia e institucioneve shtetërore për t’u angazhuar me aktorë të ndryshëm të komunitetit ka shumë mundësi të ndikojë në nivelin e qëndresës së komunitetit. Programet e PEDH-së dhe LKEDH-së kanë treguar se janë më efikase kur ka partneritet që përfshin zbatimin e ligjit, agjencitë e inteligjencës, institucionet fetare dhe OJF-të me bazë komunitare. Duke qenë se radikalizimi fetar dhe EDH-ja janë fenomene komplekse dhe shumëdimensionale, ato kërkojnë reagim shumëdisiplinor. Sipas përfaqësuesit vendor të Kavajës, komunitetet brenda qytetit kishin ulur ndjeshëm rastet e dhunës në familje dhe të të rinjve që nuk frekuentojnë shkollën, me anë të një qasjeje të ngjashme dhe falë bashkëpunimit të shtuar ndërmjet shkollave, policisë vendore, bashkisë dhe OJF-ve vendore (Përfaqësuesi i Bashkisë së Kavajës, 2018). Gjatë procesit të punës në terren dhe shqyrtimit të dokumentacionit, u konstatua se këto partneritete në rastet studimore të zgjedhura nuk janë funksionale, sidomos në Tiranë dhe Korçë, ku përfaqësuesit ligjorë dhe policia vendore bashkëpunonin shumë pak në fushën e PEDH-së/LKEDH-së. Nga ana tjetër, roli i shoqërisë civile lidhur me LKEDH-në është i ulët në Korçë dhe thuajse joekzistent në Kavajë. Ndërsa në Tiranë, pavarësisht se kishte më shumë programe me fokus te PEDH-ja, shumica prej tyre janë ende në nivel të politikave qendrore dhe është vështirë të zbatohen në terren (Përfaqësues të shoqërive civile, Tiranë 2018).

<sup>26</sup> Diskutimet me drejtuesit e Bashkisë së Kavajës dhe Tiranës nxorën në pah nevojën për koordinim qoftë nga pushteti qendror, qoftë nga OJF-të.

### 3.4. Programe dhe nisma për PEDH-në/LKEDH-në

Shumica e nismave për PEDH-në/LKEDH-në janë zbatuar nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC) me ndihmën e donacioneve dhe sponsorizimeve të huaja. Megjithatë, qeveria shqiptare ka shtuar përpjekjet për LKEDH-në. Megjithatë, është e rëndësishme që të theksohet se shumica e programeve të zbatuara nga qeveria janë në nivel kombëtar dhe zakonisht përfshijnë hartimin e strategjive për veprim dhe veprimtaritë koordinuese, por shumë pak zbatim. Nga ana tjetër, OSHC-të kanë shumë pak kohë që kanë filluar t'i zbatojnë programet nëpër komunitete. Në vijim gjendet një listë me nismat qeveritare dhe joqeveritare lidhur me përpjekjet për PEDH-në/LKEDH-në.

#### 3.4.1. Programet dhe nismat qeveritare

##### *a) Të përgjithshme*

Së fundmi, qeveria shqiptare është përpjekur të ndërmarrë masa institucionale dhe ligjore në fushën e PEDH-së. Së pari, qeveria shqiptare ndryshoi Kodin Penal (Neni 265/a dhe 265/b) në shkurt të vitit 2014, në mënyrë që të lejonte një interpretim më fleksibël të akteve terroriste ndërsa vendoste dënime më të rënda për shkelësit e ligjit (Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, 1995). Deri më tani, Shqipëria është shteti që ka disa nga dënimet më të ashpra në rajon për personat e akuzuar për terrorizëm. Së dyti, Shqipëria ishte një nga shtetet e para në rajon që miratoi një Strategji Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe një Plan Veprimi përkatës (Këshilli i Ministrave, 2015). Kësaj iu shtua edhe emërimi i Koordinatorit Kombëtar për PEDH-në, që është përgjegjës për zbatimin e strategjisë dhe koordinimin e drejtpërdrejtë me Kryeministrin. Megjithëse ky u konsiderua si një hap në drejtimin e duhur, mesa duket, vetë dokumentit i mungonte thelbi, pasi e gjithë strategjia dhe zyra e koordinatorit kombëtar ishte e nënfinancuar, pavarësisht se kishin tre vjet që funksiononin. Masa e tretë e ndërmarrë ishte për ngritjen e Qendrës për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në dhjetor të vitit 2017, që është duke u strukturuar dhe pajisur me staf (Këshilli i Ministrave, dhjetor 2017). Së katërti, qeveria është zotuar ta miratojë dhe mbështesë Qendrën e Ekselencës së NATO-s për studimin e fenomenit të luftëtarëve të huaj. Megjithatë, qendra është në pritje të miratimit nga të gjitha shtetet palë të NATO-s (Këshilli i Ministrave, shkurt 2017). Së fundi, qeveria shqiptare ka ndërmarrë disa reforma institucionale, si për shembull: miratimi i praktikave të mira për PEDH-në, rritja e kapaciteteve të trajnimit dhe logjistike për Drejtorinë e Luftës kundër Terrorizmit, përmirësimi i aftësive mbikëqyrëse dhe përmirësimi i koordinimit ndërmjet shërbimeve të inteligjencës dhe forcave të policisë (Komisioni Evropian, 2018, f. 36). Këto ndryshime pasqyrohen tek aftësia e përmirësuar e institucioneve përkatëse në zbulimin dhe prishjen e kompleteve të shumta terroriste.

Për shembull, në mars të vitit 2014, Shqipëria arrestoi nëntë imamë të vetëshpallur të një xhamie në periferi të Tiranës, që ishin përgjegjës për rekrutimin e mbi 70 luftëtarëve të ISIS-it (News, 2016). Ata u arrestuan më 12 mars 2014 dhe vendimi i formës së prerë u lëshua më 3 maj 2016. Arrestimi pati si ndikim të drejtpërdrejtë dekurajimin e luftëtarëve të tjerë të mundshëm, duke e ndërgjegjësuar kështu shoqërinë për rrezikun e EDH-së dhe duke dërguar një mesazh të fortë për përkushtimin e Shqipërisë ndaj LKEDH-së. Së dyti, në nëntor të vitit 2016, policia e Shqipërisë, me ndihmën e aleatëve rajonalë, parandaloi një sulm terrorist në ndeshjen e futbollit mes Shqipërisë dhe Izraelit (Telegrafi, 2016). Kjo rezultoi në arrestimin e 19 personave, dy prej të cilëve po vuajnë dënimin me burg, ndërsa dy të tjerë janë në arrest shtëpie. Së treti, sipas të dhënave nga KE-ja, Qeveria Shqiptare ka kryer pesë operacione për luftën kundër terrorizmit në vitin 2017, që sollën edhe arrestimin e 12 personave. (Komisioni Evropian, 2018, f. 37). Së fundi, qeveria shqiptare ka njohur rreziqet e radikalizimit në burgje, një shqetësim i ndarë me partnerët e saj të BE-së. Në janar të vitit 2018, Ministria e Drejtësisë, me mbështetjen e OSBE- së, nisi një program trajnimit për stafin e sistemit të burgjeve, që t'i pajisnin ata me aftësitë teknike dhe operacionale për parandalimin e EDH-së, që shkakton terrorizmin në burgje (Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve, 2018)."

Qeveria shqiptare ka luajtur më së shumti një rol monitorimi dhe bashkëpunimi. Megjithatë, ka pasur një mungesë të madhe të ndarjes së informacioneve me komunitetet vendore. Për shembull, megjithëse është diskutuar shumë në literaturë për faktorët që ndikojnë te EDH-ja, 3-4 vjet pas fillimit

të fenomenit të LH-së, disa nga komunitetet dhe institucionet shqiptare vazhdojnë ta kenë këtë çështje në fund të listës së tyre të prioriteteve.<sup>27</sup>

#### *b) Përfshirja dhe angazhimi i komunitetit*

Qeveria ka ndërmarrë disa masa për nxitjen e të menduarit kritik, pjesëmarrjes qytetare dhe promovimin e tolerancës përmes edukimit. Më saktësisht, ajo ka prezantuar projektin “Shkolla si Qendër Komunitare”<sup>28</sup> që nxit partneritete ndërmjet shkollave, familjeve dhe komunitetit të gjerë. Gjithashtu, qeveria ndërmori një projekt pilot për t’u mësuar fëmijëve historinë dhe kulturën e fesë. Megjithatë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk ka publikuar asnjë dokument mbi programin. Krahas kësaj, udhëheqësit fetarë janë skeptikë. Disa nga përfaqësuesit fetarë të intervistuar (si myslimanë, ashtu edhe katolikë) argumentuan se “nëse lëndët fetare nuk jepen nga institucionet e mirëfillta, atëherë do të kishte më shumë keqinformim sesa informim” (Imam në Korçë, 2018) dhe se është e rëndësishme që “të përfshihet kultura fetare në kurrikulën shkollorë” (Praktikantë të fesë islame, Kavajë 2018). Për sa i përket synimit për të “fuqizuar shoqërinë civile në mënyrë që të krijojë qëndresën e komunitetit”, nuk është ndërmarrë asnjë masë e rëndësishme dhe nuk është bërë asnjë thirrje për projekte nga institucionet shtetërore për të mbështetur OSHC-të në zonat e targetuara të pikave të nxehta, të përcaktuara në strategji (Këshilli i Ministrave, 2015, 5). Në fakt, OSHC-të kanë qenë të varura nga grantet e huaja për zbatimin e projekteve për PEDH-në/LKEDH-në.

Një tjetër fushë prioritare e qeverisë shqiptare është prezantimi i një strategjie komunikimi krijuese dhe novatore, që do t’i bashkëngjitet Strategjisë Kombëtare. Megjithatë, është bërë shumë pak për angazhimin e aktorëve të ndryshëm, si zyrtarë shtetërorë, akademikë, media dhe shoqëri të teknologjisë, shoqëria civile, komunitete fetare dhe punonjës socialë. Si rrjedhojë, ndërgjegjësimi për strategjinë dhe rreziqet e EDH-së është shumë i ulët.<sup>29</sup>

#### *c) Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse afatgjata për LKEDH-në*

Strategjia sugjeron ngritjen e sistemeve për ndarjen e informacioneve dhe protokolleve për arritjen e parandalimit më efikas të EDH-së. Megjithatë, institucionet shtetërore vazhdojnë të ngurrojnë që të ndajnë informacionet me OSHC-të apo aktorë të tjerë. Ndodh shpesh që të tilla të dhëna të mos ndahen ndërmjet njësive të ndryshme të të njëjtit institucion.

Reduktimi i burokracisë dhe ndarja e më shumë informacioneve mund të sjellin përmirësimin e efikasitetit të mekanizmave aktuale. Një aspekt pozitiv është se qeveria ka përmirësuar kapacitetet e saj institucionale përmes shtimit të trajnimeve dhe burimeve për njësitë që trajtojnë drejtpërdrejt identifikimin dhe parandalimin e hershëm të akteve të EDH-së (forcat e policisë, shërbimet e inteligjencës) (Komisioni Evropian, 2018, 36-37) dhe ka përmirësuar kapacitetet dhe rolin e mësuesve përmes projekteve që promovojnë shkollat si qendra komunitare. Megjithatë, nevojiten më shumë trajnime për punonjësit e administratës publike vendore. Ata u përgjigjën si më poshtë për pyetjen “A njiheni me Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm?”:

*“Nuk jam në dijeni të ekzistencës së Strategjisë Kombëtare. Nuk kam marrë pjesë në asnjë trajnim lidhur me këtë aspekt” (Përfaqësues i Bashkisë së Korçës, 2018).*

*“Jo, nuk jam në dijeni. Nuk ka pasur trajnime për këtë temë as nga institucionet shtetërore, dhe as nga shoqëria civile. Do të ishte më mirë sikur të përfshiheshim në të tilla aspekte, sepse kështu do e mbronim më mirë harmoninë tonë fetare” (Përfaqësues i Bashkisë së Kavajës, 2018)*

*Jo, nuk jam në dijeni të ekzistencës së strategjisë, pasi nuk ka pasur bashkëpunim në këtë aspekt. Besoj se përgjegjësia për trajtimin e këtyre problemeve i mbetet institucioneve të sigurisë” (Përfaqësues i Bashkisë së Tiranës, 2018)*

<sup>27</sup> Përfaqësuesi i Bashkisë së Korçës dukej se ishte i njohur me çështjen më shumë si një qytetar i shqetësuar sesa si një punonjës i pushtetit vendor. Në fakt, institucioni nuk ishte i njohur me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për luftën kundër EDH-së. Anëtarët e fokus grupit dhe përfaqësuesit e Bashkisë së Kavajës ishin informuar rreth kësaj problematike falë fushatës së ndërgjegjësimit të organizuar nga një projekt i OSHC-së. Të dy kryetarët e njësive bashkiake në Tiranë nuk e konsideruan atë as si shqetësim dhe ishin të mendimit se këto veprime janë rezultat i personave problematikë që veprojnë më vete.

<sup>28</sup> Për informacione të mëtejshme rreth projektit “Shkolla si Qendër Komunitare” në Shqipëri, kontrolloni udhëzimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA): <http://myschool.al/resources/programedoc2.pdf>

<sup>29</sup> Këto pikëpamje u ndanë gjatë intervistave me punonjësit e administratës publike vendore në Tiranë, Korçë dhe Kavajë.

<sup>30</sup> Kur pyetëm një përfaqësues të policimit në komunitet nëse ekziston një bashkëpunim ndërkombëtar ndërmjet individëve radikalë në Korçë dhe radikalëve të huaj, ai u përgjigj: “Personalisht, nuk kam informacione lidhur me këtë, pasi puna jonë në polici është e ndarë sipas drejtorive të ndryshme dhe nuk kemi akses në drejtori të tjera përveç tonës”

### 3.4.2. Shoqëria civile dhe komunitetet fetare

Janë ndërmarrë dhe po ndërmerren nisma të shumta nga shoqëria civile dhe komunitetet fetare në Shqipëri, me qëllim PEDH-në dhe LKEDH-në. Megjithatë, fokusi kryesor ka qenë frenimi dhe parandalimi i EDH- së dhe nuk janë zhvilluar programe konkrete për trajtimin e individëve dhe grupeve, veprimet dhe fjalët e të cilëve konsiderohen radikale. Zyrtarët fetarë u shprehën se gjatë viteve të fundit, në disa zona të caktuara ka pasur radikalizëm, megjithatë, niveli i kërcënimit nuk është aq i lartë sa mendohet. Sidoqoftë, ata na paralajmërojnë që këta individë mund të vazhdojnë të kenë ide radikale, të cilat po i ndrydhin vetëm sepse kanë frikë se mund të ndiqen penalisht. Ndaj, kërcënimi i radikalizmit mund jetë i fshehur në sfond dhe me shumë mundësi mund të shfaqet kur të gjendet rasti i përshtatshëm. Gjatë punës në terren, myftinjët dhe imamët vendorë u shprehën për ekzistencën e grupeve apo individëve radikalë, në Yzberisht (Tiranë) dhe në Korçë.<sup>31</sup> Siç e thekson dhe Myftiu i Tiranës, është me rëndësi që të angazhohemi dhe të punojmë për deradikalizimin e këtyre individëve sa më shpejt që të jetë e mundur. Sipas myftiut, angazhimi dhe komunikimi mund të shërbejnë si një mundësi për shumë individë, që t'ia largohen nga rruga e radikalizimit.

*“Është shumë e rëndësishme që të komunikohet me këta njerëz, pavarësisht kundërshtive të tyre. Për shkak të këtij hendeku në komunikim, ka shumë individë që nuk duan të jenë pjesë e këtyre grupeve, por që kanë ngecur aty sepse institucionet zyrtare nuk veprojnë dhe sepse ata nuk kanë mundësi zgjedhjeje” (Myftiu i Tiranës, 2018)*

Nismat aktuale për PEDH-në në Shqipëri ndërmerren në mënyra të ndryshme dhe iu drejtohen grupeve të ndryshme. Fokusi kryesor kanë qenë gratë, rinia, komuniteti rom, radikalizimi në internet dhe trajnimi dhe ndërgjegjësimi i mediave për EDH-në. Grupmosha më e rrezikuar konsiderohet të jetë rinia dhe prandaj projektet përqendrohen më shumë tek ato. Qarku i Elbasanit dhe rrethinat e tij kanë qenë në qendër të problematikave të EDH-së, duke pasqyruar ekzistencën e shumë luftëtarëve të huaj dhe fjalimeve radikale dhe ka numrin më të madh të projekteve për PEDH-në. Synimi i këtyre nismave ka qenë forcimi i kapaciteteve, fuqizimi i partnerëve vendorë, përcaktimi i rolit të shkollave si qendra komunitare dhe nxitja e tolerancës fetare.

Nuk është e thjeshtë që të vlerësohet efikasiteti dhe ndikimi i këtyre programeve, pasi thuhet të gjitha po zbatohen aktualisht. Për më tepër, këto programe janë përqendruar më së shumti te PEDH-ja, që nënkupton se rezultatet e projektit pritet të jenë afatgjata, ndaj është e vështirë që të vlerësohet ndikimi i tyre afatshkurtër.

### 3.4.3. Nisma konkrete për rastet studimore (Korçë, Tiranë, Kavajë)

Shumica e projekteve për PEDH-në janë zbatuar në Tiranë, ndërsa disa të tjera në Korçë. Kavaja është në vend të fundit, me asnjë projekt për PEDH-në/LKEDH-në në zbatim.

Dy projektet kryesore në Korçë, të mbështetura nga Bashkimi Evropian, janë:

- “Edukimi i të rinjve me kulturën e tolerancës dhe të mirëkuptimit për krijimin e një shoqërie miqësore”, zbatuar nga Instituti Shqiptar për Çështjet Publike. Projekti përqendrohet tek angazhimi i të rinjve për nxitjen e harmonisë dhe mirëkuptimit ndërmjet komuniteteve të ndryshme fetare dhe etnike.
- “Rrjeti i Parandalimit të Ekstremizmit të Dhunshëm”, zbatuar nga Gruaja në Zhvillim, Korçë. Projekti ka si synim krijimin e një rrjeti bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe organizatave, që nxisin masat për PEDH-në.

Aktualisht në Tiranë po zbatohen gjashtë projekte të mbështetura nga donatorë të huaj të ndryshëm.

→ Shoqata “Young Men’s Christian Association” në Tiranë: zbatimi i një projekti që synon ofrimin e kontributit për zbatimin vendor të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm përmes rritjes së nivelit të informimit në komunitetet periferike të Tiranës.

→ Akademia a Studimeve Politike: zbatimi i një projekti që synon prezantimin e mekanizmave të

<sup>31</sup> Këto pikëpamje u ndanë gjatë intervistave me myftinjve të Tiranës dhe Korçës. Grupi radikal në Tiranë shkon nëpër shumë xhami periferike, duke rënëjosur formën uahabiste të praktikimit të islamit dhe ka qenë përgjegjës për radikalizimin e shumë individëve të tjerë. Një grup me rreth 15 individë në Korçë është raportuar të ketë prirje ekstremiste. Megjithatë, praktikat e tyre nuk përputhen me asnjë nga traditat kryesore të Islamit.

politikave novatore për parandalimin e radikalizimit të të rinjve dhe LKEDH-së në komunitetet vendore në Shqipëri përmes reagimit ndaj mangësive të ndryshme, si për shembull, mosinformimi i të rinjve për rreziqet që iu kanosen nga radikalizimi dhe EDH-ja, interesi i pakët i zyrtarëve vendorë dhe organizatave vendore bazë për trajtimin e problemit.

- Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe të Torturës: zbatimi i një projekti që synon trajtimin e “pjesëve që mungojnë për identifikimin dhe parandalimin e hershëm”, në mënyrë që të arrihet deradikalizimi dhe mosangazhimi afatgjatë.
- Shoqata Ndërkombëtare për Solidaritet: zbatimi i një projekti që synon zhvillimin e kapaciteteve dhe nxitjen e pjesëmarrjes së palëve vendore të interesit në masat e koordinuara për parandalimin e radikalizimit dhe EDH-së të të rinjtë.
- Qendra Shqiptare për Komunikim Publik: zbatimi i një projekti që synon ofrimin e kontributit për luftimin dhe parandalimin e përhapjes së EDH-së dhe radikalizimit në Paskuqan, zonë periferike e Tiranës, përmes zbatimit të seancave të ndërgjegjësimit dhe leksioneve të hapura publike.
- INFINIT+: zbatimi i një projekti për krijimin e qëndresës të të rinjtë që praktikojnë fenë islame, dhe refuzimi i përpjekjeve për t'i përfshirë në radikalizimin apo ekstremizmin e dhunshëm.

Është e rëndësishme të theksohet se komuniteti që shfaq shenjat më të mëdha të qëndresës në Kavajë, është po ai ku nuk është zbatuar asnjë projekt i jashtëm për PEDH-në. Nga ana tjetër, kjo mund të konsiderohet si një marrëdhënie shkak-pasojë, ku projektet përqendrohen më së shumti tek ato komunitete ku është identifikuar problemi, ndërsa mungesa e domosdoshmërisë për ndërhyrje të jashtme te programet për PEDH-në mund të jetë një tregues i qëndresës së Bashkisë së Kavajës.

### 3.5. PEDH-ja dhe përpjekjet për vendosjen e paqes dhe për pajtim.

Është e rëndësishme që të theksohet se në Shqipëri nuk janë zbatuar asnjëherë programe të përshtatshme pajtimi me qëllim zgjidhjen e konflikteve dhe/ose vendosjen e paqes. Ndryshe nga shumica e vendeve fqinje, konfliktet e brendshme në Shqipëri mund të lidhen më së shumti me tensionet politike sesa me ato fetare apo etnike. Kjo është edhe arsyeja pse pajtimi, dialogu dhe ndërmjetësimi janë trajtuar gjithmonë si pjesë e panoramës politike sesa si pjesë e programeve për t'u zbatuar në nivel social. Si rezultat, përpjekjet aktuale të PEDH-së mund të lidhen me vendosjen e paqes nëpërmjet programeve të dialogut ndërfetar, ndërgjegjësimit dhe promovimit të vlerave qytetare përmes edukimit. Këto programe janë përmendur edhe në seksionin e mëparshëm.

Ky është viti i tretë që Shqipëria zbaton Strategjinë Kombëtare për LKEDH-në me një sërë nismash të shoqërisë civile që synojnë ndërgjegjësimin, ngritjen e kapaciteteve dhe ndërmarrjen e praktikave për PEDH-në. Megjithëse nuk është përgatitur akoma Progres Raporti për zbatimin e strategjisë, pritet që të ketë një lloj lodhjeje lidhur me PEDH-në/LKEDH-në ndërmjet atyre aktorëve fetarë që kanë qenë shumë aktivë për sa i përket masave për PEDH-në/LKEDH-në gjatë këtyre tre ose më shumë viteve të fundit. Megjithëse gjatë vitit të fundit (2016/2017) koordinimi i donatorëve për programet për PEDH-në/LKEDH-në është përmirësuar, sipas burimeve të shumta nga ky studim, ka mbipërqendrim të nismave për PEDH-në/LKEDH-në në Shqipëri, që nuk pasqyron shkallën (relativisht të ulët) e kërcënimeve nga EDH-ja në krahasim me vendet fqinje (p.sh: Kosovë apo Maqedoni).

Një veçori tjetër e fenomenit shqiptar të EDH-së është fakti se, deri më tani, përmes LH-ve, ai ka paraqitur më shumë kërcënime të jashtme se sa të brendshme. Lidhur me këtë, shumë burime u shprehën se ka shumë pak gjasa që ekstremizmi i dhunshëm nga qytetarët shqiptarë të rezultojë në sulme serioze apo incidente terroriste brenda vendit. Ndonëse këto qëndrime nuk nënkuptojnë aspak që përpjekjet për PEDH-në duhet të ndalohen, përvoja e fundit me masat për PEDH-në/LKEDH-në të ndërmarranë Shqipëri kërkojnë kontekstualizim të mëtejshëm.

Gjendja e EDH-së në Shqipëri nuk paraqet të njëjtat veçori që praktikantët kanë vërejtur në vende të tjera, sidomos në Ballkanin Perëndimor, ku identitetet fetare dhe kombëtare janë përfshirë shpesh në

konfliktet e mëparshme (p.sh: ish luftërat jugosllave gjatë viteve 1990). Mbizotërimi i identitetit kombëtar mbi atë fetar në Shqipëri, e izoloi fenomenin dhe ndjekësit e kësaj ideologjie ekstremiste gjenden kështu në një kontekst ku nuk mund të identifikojnë komunitetet kundërshtarë. Një përfundim i ngjashëm u arriti edhe nga vlerësimi i metodologjisë së studimit të IDM-së në vitin 2018 “Toleranca Fetare në Shqipëri”, në të cilin deklarohet se konteksti shqiptar është i ndryshëm nga konteksti historik, socio-politik dhe ekonomik i vendeve, që i angazhojnë komunitetet e tyre në vendosjen e paqes pas konflikteve dhe në ndërmarrjen e masave pajtuese (Vurmo, e të tjerë, 2018, 10).

Pavarësisht incidenteve të izoluara (që janë dënuar gjithmonë), fenomeni i EDH-së në Shqipëri mbetet i kufizuar në rastet e individëve të radikalizuar, që manipulohen përmes ideologjive ekstremiste. Këto raste janë shumë larg nivelit të një apo më shumë grupeve të strukturuar (dhe aq më pak komuniteteve), për të cilët do të nevojiteshin masa komplekse për pajtimin (joekzistent) e grupeve kundërshtarë apo përpjekjeve për vendosjen e paqes ndërmjet komuniteteve kundërshtarë në Shqipëri. Për rrjedhojë, është thelbësore që përpjekjet për PEDH-në në Shqipëri të vazhdojnë të përshtatin kontekstin vendor me anë të masave me në qendër PEDH-në.

Nismat më të fundit, që kombinojnë përpjekjet për PEDH-në me pajtimin social në Shqipëri, janë strategjitë e deradikalizimit. Megjithatë, aktualisht nuk është zbatuar asnjë program i rëndësishëm deradikalizimi në terren. Deradikalizimi si një proces, synon individët radikalë dhe mbështetet te supozimi se jo të gjithë personat radikalë mbeten të përkushtuar ndaj kauzës, dhe se çdo grup radikal ka ndjekës të zhgënjyer, dyshues, apo që thjesht duan të largohen (Neumann, 2017). Programimi për PEDH-në është një proces afatgjatë, ashtu si edhe ndikimi i tij, dhe megjithëse ai ka forcuar bashkëpunimin me aktorë që ndajnë të njëjtin mendim në Shqipëri, nuk ka pasur sukses në zgjidhjen e sfidave afatshkurtra sepse nuk synon, trajton apo integron individët radikalë. Mungesa e programeve që synojnë individë të radikalizuar mund të sjellë dështimin e përpjekjeve për LKEDH-në, lidhur me sheshimin e hendeqeve ndërmjet individëve të radikalizuar dhe pjesës tjetër të shoqërisë. Programet e deradikalizimit janë të rëndësishme për përballjen me kërcënimet që kanosen nga EDH-ja dhe hedhin bazat për përdorimin e mëtejshëm të ish individëve të radikalizuar në nisma të ardhshme për LKEDH-në dhe qëndresën e komunitetit.



## 4 Përfundime dhe rekomandime

EDH-ja e nxitur nga terroristët është një fenomen relativisht i ri në Shqipëri, dhe si i tillë, në prag të konfliktit sirian, i kapi në befasi shumë nga institucionet qeveritare dhe shoqërinë shqiptare, ku mbi 140 burra dhe gra u larguan nga vendi për të mbështetur grupe të ndryshme militantësh të përfshirë në konflikt. Qeveria shqiptare reagoi nëpërmjet ndryshimit të kodit të saj penal, rritjes së kapaciteteve të forcave të policisë, krijimit të Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për LKEDH-në dhe miratimit të një Strategjie Kombëtare për këtë çështje. OSHC-të, në bashkëpunim me donatorët ndërkombëtarë, ndërmorën nisma të tjera për të kuptuar më mirë shkaqet dhe ndikimin e fenomenit, dhe për të ndërgjegjësuar pushtetin vendor, institucionet arsimore dhe forcat e sigurisë përmes projekteve që angazhonin komunitetet fetare.

Një pjesë e madhe e përpjekjeve fillestare të qeverisë ishin përqendruar në ndjekjen penale, si një mekanizëm për pengimin e simpatizantëve të tjerë për të udhëtuar drejt zonave të konfliktit dhe për mbështetjen e grupeve të luftëtarëve jashtë kufijve. Projekte të tjera joqeveritare synonin ndërgjegjësimin dhe sigurimin e mbështetjes fillestare për komunitetet e prekura, duke e trajtuar fenomenin nga një dimension i caktuar (feja, arsimimi, problemet ekonomike, etj.). Megjithatë, një anë negative e këtyre projekteve ishte fokusi i tyre te karakteristikat individuale (nxitësit parësorë, faktorët mundësues, mekanizmat për parandalim); disa synuan komunitetet si tërësi për të vëzhguar faktorët dhe aktorët që i bëjnë më të qëndrueshëm apo të cenueshëm ndaj EDH-së; ky studim analizoi pikërisht këto komunitete. Bashkitë e Kavajës, Korçës dhe Tiranës u morën si raste studimore për shkak të ndryshimeve të identifikuar në nivelin e prekshmërisë, pas hetimeve fillestare dhe të shqyrtimit të dokumentacionit. Studime të mëtejshme treguan se faktorët që prekin si cenueshmërinë, ashtu edhe qëndresën e komunitetit, ndahen në tre kategori kryesore: strukturorë, socio-ekonomikë dhe ideologjikë. Ndërsa analizonte faktorët e qëndresës dhe aktorët që ndikojnë te prekshmëria nga EDH-ja brenda një komuniteti, studimi nxori disa përfundime.


Së pari, qëndresa është një *spektër*, dhe është sistematike, ndërsa radikalizimi ndaj EDH-së është një *proces*, shkalla e të cilit varet shumë (por je vetëm) nga niveli i qëndresës. Qëndresa duhet të konsiderohet si një spektër, pasi nuk ka qëndresë të përsosur, por vetëm një bashkim faktorësh dhe masash nga aktorë që kufizojnë cenueshmërinë në komunitet (apo përmirësojnë qëndresën). Në këtë aspekt, megjithëse një komunitet nuk është prekur nga EDH-ja, ai mund të shfaqë shenja të cenueshmërisë, duke përbërë kështu një formë të “qëndresës rastësore” (Turçalo, 2018). Nga ana tjetër, një komunitet që paraqitet i qëndrueshëm, duke plotësuar kriteret e qëndresës, mund të preket për shkak të faktorëve të jashtëm të ndërhyrjes, dhe kështu përjeton akte të izoluara dhe të nxitura nga individët (zakonisht quhen sulme nga ujqërit e vetmuar). Për rrjedhojë, kur hetoni për qëndresën, pyetja që duhet të ngrini nuk është “I qëndrueshëm apo jo?”, por “si dhe sa i qëndrueshëm është një komunitet?” Qëndresa është sistematike sepse nuk varet vetëm nga një faktor i vetëm i qëndresës, por nga ndërlidhja e përgjithshme e faktorëve dhe nga mënyra se si aktorët luajnë rolin e tyre në formimin e atyre faktorëve. Për më tepër, për shkak të shumëllojshmërisë së mënyrave me anë të të cilave faktorët dhe aktorët mund të ndërlidhen në një komunitet të caktuar, qëndresa ndaj EDH-së nuk është domosdoshmërisht e qëllimshme, por shpeshherë, ndodh rastësisht. Kjo është një arsye më tepër se përse qëndresa duhet të analizohet në mënyrë gjithëpërfshirëse. Gjithsesi, qëndresa ndaj EDH-së mund të nxitet përmes përmirësimit të efikasitetit të një grupi të caktuar faktorësh dhe aktorësh. Së fundi, radikalizimi ndaj EDH-së (prekshmëria) është një proces, pasi ndodh me kalimin e kohës dhe përmes një sërë ngjarjesh. Megjithëse lidhet me cenueshmërinë, me më gjasa, ai mund të ndodhë në komunitetet ku qëndresa duket të jetë e lartë. Në përgjithësi, sipas faktorëve dhe aktorëve të identifikuar, nga të tre komunitetet e analizuar, Kavaja paraqitet të jetë bashkia më e qëndrueshme, e ndjekur nga Korça dhe më pas nga Tirana.

Së dyti, duke konfirmuar një nga hipotezat e këtij studimi, të dy faktorët për parandalimin e EDH-së janë të pranishëm si te komunitetet e qëndrueshme, ashtu edhe tek ato të cenueshme. Megjithatë, janë faktorët shtesë ndërhyrës ata që “nxisin” cenueshmërinë në disa komunitete në rrezik. Sidoqoftë, ekziston një lidhje

pozitive ndërmjet faktorëve të qëndresës dhe paprekshmërisë. Për rrjedhojë, siç e vërtetojnë edhe rastet studimore, faktorët e *përbërë* të cenueshmërisë kanë më shumë mundësi që të sjellin prekshmëri nga EDH-ja, dhe nuk është e mundur që një faktor i vetëm ta parashikojë prekshmërinë. Për shembull, në Tiranë mund të vihet re prania e treguesve, si LH-të, gjuha e urrejtjes ndaj fesë dhe institucionet e tjera shtetërore, izolimi nga komuniteti në përgjithësi, prania e rekrutuesve radikalë dhe ndikimi i burimeve të jashtme radikale të financimit (grupet uahabi). Nuk ka raste të LH-ve në Bashkinë e Korçës, por ka pasur raste të incidenteve të dhunës fetare (brenda dhe jashtë fesë), ka donacione dhe predikues të huaj dhe nuk ka bashkëpunim dhe koordinimin me institucionet e tjera (institucione të sigurisë, pushteti vendor, arsimit, etj.). Nga ana tjetër, Kavaja ka pasur donacione nga të huaj, por shpërndarja ishte e kontrolluar, aktorët fetare i koordinonin vazhdimisht veprimtaritë e tyre, gjuha e urrejtjes shmangej përmes predikimit që nxiste tolerancë, dhe megjithëse Kavaja është një komunitet relativisht fetar, i kushtohet shumë rëndësi vlerave qytetare dhe kohezionit social.


Së treti, është e rëndësishme që të bëhet dallimi ndërmjet pa/prekshmërisë dhe qëndresës. Megjithëse ata mbivendosen dhe lidhen me njëra-tjetrën, ata nuk masin të njëjtën gjë. Prekshmëria lidhet me shenjat e dukshme të EDH-së, ndërsa qëndresa lidhet me aftësinë për të parandaluar, shmangur dhe reaguar ndaj kërcënimeve përmes masave kolektive. Megjithëse këto variabla nuk masin të njëjtën gjë, niveli i rrezikut dhe lloji i kërcënimit në një komunitet të caktuar mund të ndryshojnë në mënyrë drastike, mbështetur në nivelin e cenueshmërisë dhe llojin e prekshmërisë së pranishme. Prandaj, komunitetet që shfaqin nivele të larta të cenueshmërisë ndaj EDH-së dhe ato që janë prekur, janë më të rrezikuar dhe përballen me një kërcënim më të madh se komunitetet që nuk janë prekur (dukshëm) dhe shfaqin shenja qëndrese ndaj EDH-së. Komunitetet e vëzhguara shfaqën një lidhje pozitive ndërmjet prekshmërisë dhe cenueshmërisë, që nënkupton se komunitetet e cenueshme kanë më shumë gjasa të preken nga EDH-ja. Prekshmëria në këtë rast nuk merr në konsideratë vetëm numrin e LH-ve, por edhe krimet e urrejtjes, diskriminimin dhe vepra të tjera ekstremiste që kanë motivacion ideologjik. Diagrama e mëposhtme ndihmon për t'i shpjeguar këto lidhje të shumta:<sup>32</sup>

3



<sup>32</sup> Diagrama është mbështetur te vëzhgimi i lidhjeve ndërmjet prekshmërisë nga EDH-ja dhe rezistencës së komunitetit në rastet studimore të zgjedhura. Megjithatë, ajo është mbështetur edhe te Strategjia e Mbretërisë së Bashkuar për Luftën kundër Terrorizmit (CONTEST), e disponueshme në <https://rm.coe.int/the-united-kingdom-s-strategy-for-countering-terrorism-june-2018/16808b05f3>

Së katërti, EDH-ja shfaqet te pika e përbashkët ndërmjet ideologjisë, zemërimit dhe mundësisë. Të gjithë faktorët dhe aktorët kryesorë prekin komunitetet e tyre duke formuar një nga këta tre mundësues të EDH- së. Ideologjia e forcon komunitetin me një sërë besimesh me të cilat identifikohen. Nga ana tjetër, zemërimi përfaqëson pakënaqësinë e përgjithshme që kanë individët ndaj ideologjisë, aspekteve socio- ekonomike dhe politike të jetës së tyre. Së fundi, “mundësia” është aftësia e individëve për të kryer akte të EDH- së pa u penguar. Në vitin 2012, kur LH-të e Shqipërisë filluan të largoheshin për në Siri, disa individë ishin tepër të bindur për kauzën e tyre. Kjo nismë u forcua dhe më shumë për shkak të pakënaqësisë ndaj mënyrës se si po jetonin. I tillë ishte edhe rasti i Tiranës, ku shumë nga LH-të përvetësuan një ideologji radikale të fesë (uahabizëm), që mbizotëroi në të gjitha aspektet e jetës socio-politike. Mospajtimi me realitetet sociale dhe politike çoi në izolimin dhe shtimin e pakënaqësisë dhe kur u paraqit mundësia, këta ekstremistë u larguan nga vendi për të bërë luftëtarë të huaj.



Së pesti, ndikimi negativ i ideologjisë, zemërimit dhe mundësisë për të bërë ekstremist i dhunshëm mund të shmangen ndjeshëm përmes (1) kohezionit social, (2) forcimit të vlerave qytetare, (3) shtimit të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të komunitetit dhe (4) përmirësimit të performances institucionale. Sipas studimit, komunitetet me angazhim social në nivel të lartë dhe respekti për diversitetin dhe vlerat qytetare ishin më pak të prekura nga EDH-ja. I tillë është edhe rasti i Korçës dhe Kavajës (sidomos i Kavajës), ku kishte shumë ndërlidhje ndërmjet njerëzve të besimeve fetare të ndryshme dhe ku aktorët fetarë nxisnin respektin dhe tolerancën ndaj feve të tjera. Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të komunitetit ishte edhe më i lartë në Kavajë, pasi pushtetit vendor, forcat e

sigurisë, institucionet arsimore dhe komuniteti fetar kishin bashkëpunim më të madh ndërmjet tyre. Bashkëpunimi dhe ndërlidhja ishin më të ulëta në Tiranë. Kjo nxiti izolimin e individëve dhe grupeve ideologjike ku ata bënin pjesë. Së fundi, megjithëse performanca institucionale u kritikua njëlloj në të gjitha komunitetet, mesa duket prania e shtetit është më e lartë në Kavajë, sesa në Korçë dhe Tiranë. Ndërsa në komunitetin e Kavajës, aktorët e pranuan ndikimin e EDH-së në komunitet dhe të veprimeve të qeverisë për LKEDH-në, në Korçë dhe Tiranë, shumë nga institucionet vendore e mendonin këtë problem si të papërfillshëm dhe nuk njiheshin me mekanizmat për referim apo parandalim.

Së fundi, ekzistenca e faktorëve që nxisin qëndresën mund të forcojë komunitetet dhe të shmangë që ato të preken edhe në rastet kur faktorët e cenueshmërisë janë të pranishëm, sidomos në prani të angazhimit proaktiv nga aktorët që promovojnë qëndresën. Megjithëse ka një ndërlidhje mes mungesës së aktorëve negativë dhe qëndresës më të madhe, e rëndësishme është që ka një ndërlidhje me mosveprimin e aktorëve pozitivë dhe cenueshmërisë. Prandaj, *angazhimi proaktiv* dhe *veprimi* i aktorëve të komunitetit është thelbësor për forcimin e qëndresës më shumë sesa mungesa e faktorëve të cenueshmërisë. Kjo u vëzhgua në nivele të ndryshme në të tria komunitetet. Në Kavajë, atje ku qëndresa e komunitetit është më e lartë, komuniteti ndërvepronte ngushtësisht në nivele të shumta dhe aktorët ishin proaktivë në PEDH. Ky koordinim dhe masat parandaluese në veçanti, ishin të dukshme në komunitetin fetar, dhe që në fazat fillestare të fenomenit të LH-ve, ata reagueshan duke trajtuar disa nga shfaqjet e para të zemërimit të praktikantëve të tyre, duke shmangur situata ku keqinformimi mund t'i detyronte individët që t'i merrnin frerët vetë në dorë. Nga ana tjetër, paaftësia e aktorëve të komunitetit në Tiranë për të reaguar në kohë ndaj radikalizmit dhe ekstremizmit në zhvillim e rëndoi situatën deri në atë pikë sa shumë praktikantë u rekrutuan si LH. Aktorët mund të kenë një ndikim të madh te qëndresa apo cenueshmëria e një komuniteti, pasi mund të ndihmojnë në reduktimin e cenueshmërisë nga një anë dhe në nxitjen e zemërimit dhe rritjen e cenueshmërisë nga ana tjetër. Për më tepër, aktorët mund të shërbejnë si forca mobilizuese të një ideologjie të përbashkët duke formuar perceptimet dhe duke trajtuar zemërimin.

## Rekomandime

Lufta kundër radikalizimit mund të jetë një proces i ndërlikuar, prandaj edhe parandalimi duhet të jetë fokusi parësor i qeverisë shqiptare. Për sa i përket kësaj, krijimi i qëndresës së komunitetit mund të shërbejë si një zbutës afatgjatë ndaj radikalizimit dhe EDH-së. Njohja e faktorëve dhe aktorëve që ndikojnë në qëndresën e komunitetit është hapi i parë drejt këtij synimi. Megjithatë, qeveria shqiptare duhet të përqendrohet edhe në zbatimin konkret të strategjive për parandalimin e EDH-së përmes angazhimit proaktiv të komuniteteve.

Ashtu siç u theksua edhe në disa prej përfundimeve të sipërpërmendura, nuk ka zgjidhje magjike për qëndresën ndaj EDH-së. Megjithatë, ajo është e lidhur pozitivisht me praninë e faktorëve të qëndresës dhe me angazhimin proaktiv të aktorëve që nxisin qëndresën dhe kohezionin social. Për më tepër, gjatë studimit dolën në pah karakteristika të ndryshme lidhur me faktorët dhe aktorët që mundësuan qëndresën e komunitetit, po ashtu edhe disa nga rekomandimet gjithëpërfshirëse për krijimin e qëndresës më të mirë të komunitetit ndaj EDH-së, që janë si më poshtë:

- *Forcimi i vlerave dhe identitetit qytetar.* Vlerat e përbashkëta dhe identiteti qytetar ndihmojnë në ofrimin e një forme të veçantë të identifikimit për të gjithë qytetarët. Tërheqja e vëmendjes dhe nxitja e qytetarëve për t'i qëndruar parimeve të respektimit të të drejtave dhe lirive të njerëzve të tjerë, të tolerancës fetare, bashkëpunimit për sigurinë e përbashkët, pranimit të diversiteti, mosdiskriminimit, dhe respektimit të shtetit të së drejtës mund të forcojnë lidhjet e komunitetit, ndërsa i nxisin qytetarët e një komuniteti për të jetuar në harmoni dhe duke respektuar liritë individuale.
- *Kohezioni social.* Baza e qytetarisë së përgjegjshme është krijimi i një identiteti të fortë qytetar të mbështetur në vlerat qytetare, por kohezioni social është shumë më i rëndësishëm për krijimin e lidhjeve sociale, urave lidhëse dhe marrëdhënieve në komunitet dhe ndërmjet tyre. Siç u shpjegua dhe më parë, këto lidhje shoqërore ndihmojnë në krijimin e ndjenjës së përkatësisë për të gjithë pjesëtarët e komunitetit, në reduktimin e izolimit dhe marginalizimit, dhe në rritjen e bashkëpunimit dhe partneritetit ndërmjet komunitetit dhe institucioneve qeveritare.
- *Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të komunitetit.* Ndërlidhja nxitet më tej kur aktorët e komunitetit bashkëpunojnë për përmbushjen e qëllimeve të përbashkëta. Kështu rriten edhe mundësitë për të identifikuar dhe trajtuar shqetësimet sociale, që mund të kalojnë pa u vënë re. Sa më i madh angazhimi proaktiv i aktorëve në një komunitet të caktuar, aq më e madhe mundësia për trajtimin e problemeve lidhur me EDH-në. Siç e pasqyron dhe ky studim, veprimi i aktorëve të komunitetit mund të ndihmojë në ruajtjen e qëndresës së komunitetit, madje edhe kur ka faktorë që favorizojnë cenueshmërinë ndaj prekshmërisë nga EDH-ja.
- *Përmirësimi i performancës institucionale/ qeverisjes së mirë.* Qeverisja e mirë i ndihmon njerëzit që t'i trajtojnë më shpejt shqetësimet e tyre socio-ekonomike dhe politike. Kjo përmirëson besimin e qytetarëve tek institucionet, trajton zemërimin dhe redukton mundësinë për individët e radikalizuar për t'u angazhuar në mënyrë të suksesshme në EDH.

Siç tregohet në këtë studim, prekshmëria nga EDH-ja lidhet më së shumti me komunitetet ku karakteristikat socio-politike dhe ekonomike të sipërpërmendura nuk i përmbushin nevojat sociale. Kështu, nismat proaktive, që kontribuojnë në përmirësimin e këtyre rezultateve afatgjata, do të luajnë një rol domethënës në forcimin e qëndresës së komunitetit. Mekanizmat për ofrimin e këtyre rezultateve mund të ndryshojnë në varësi të arsimimit dhe fushatave ndërgjegjësuëse, projekteve me shumë palë interesi të udhëhequra nga komuniteti, forcimit të kapaciteteve dhe vlerësimit të politikave dhe këshillave që të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i efikasitetit të politikave, dhe që të krijohen mundësi për rezultate më efikase.

# Fjalorth

**Komunitet i prekur** – për qëllim të këtij studimi, ky është një komunitet i prekur nga format ideologjike dhe/ose fizike të EDH-së, si për shembull: ideologji radikale të përhapura, akte dhune me motive ideologjike, shpeshësia e luftëtarëve të huaj me origjinë nga komuniteti, dhe prania e aktorëve që nxisin cenueshmërinë ndaj EDH-së.

**Komunitet** – në kuadër të këtij studimi, një komunitet është një grup njerëzish dhe institucionesh, zakonisht me bazë në të njëjtën zonë, që kanë interesa, identitete apo karakteristika të përbashkëta.

**Radikalizëm i fshehur** – i referohet nuancave të radikalizimit, që ekzistojnë në mënyrë të fshehur në një komunitet. Kjo formë e radikalizimit nuk identifikohet nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë, por fillon e bëhet e dukshme pas analizave të mëtejshme të nënteksteve të ndërveprimeve sociale, në formën e stereotipave, gjuhës së urrejtjes, diskriminimit të fshehur dhe superioritetit të përgjithshëm të besimit të një personi.

**Lufta kundër radikalizimit** – përfshin politikat dhe programet që synojnë trajtimin e disa prej kushteve që mund t'i çojnë disa individë drejt rrugës së terrorizmit. Përdoret gjerësisht për t'iu referuar një pakete programesh sociale, politike, ligjore, arsimore dhe ekonomike të hartuara posaçërisht për të frenuar individët jo të prekur (dhe mundësisht të radikalizuar) nga kalimi i vijës së kuqe dhe shndërrimi i tyre në terroristë (Task Force e Kombeve të Bashkuara për Zbatimin e Strategjisë kundër Terrorizmit - UN CTITF).

**Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm (LKEDH)** - nënkupton nisma dhe strategji që përqendrohen te lufta kundër procesit të radikalizimit dhe frenimi i rekrutimit të ekstremistëve të dhunshëm. Është një reagim gjithëpërfshirës që synon mobilizimin dhe fuqizimin e aktorëve të ndryshëm si për shembull, pushtetin vendor, arsimtarët, punonjësit socialë, komunitetin fetar dhe shoqërinë sociale, me qëllim promovimin e vlerave qytetare dhe respektimin e të drejtave të njeriut. LKEDH-ja trajton edhe “kushtet që favorizojnë” përhapjen e EDH-së dhe terrorizmit duke marrë parasysh dhe duke ndihmuar në zbutjen e zemërimit, që mund të shfrytëzohen nga ekstremistët dhe mbështetësit e tyre.

**Lufta kundër terrorizmit** - i referohet të gjitha masave të marra për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, para, gjatë dhe pas kryerjes së akteve terroriste; synon frenimin e akteve terroriste, ndalimin e kompleteve terroriste dhe shpërbërjen e organizatave terroriste.

**Deradikalizimi** – është një proces që kryhet më së shumti përmes një sistemi programesh dhe masash që synojnë uljen e shkallës së gjerë të pikëpamjeve ideologjike dhe riintegrimin e individëve që janë radikalizuar në shoqëri. Mbështetet te supozimi se jo të gjithë personat që radikalizohen mbeten të angazhuar ndaj kauzës së tyre. Programet e deradikalizimit, në praktikë synojnë individët e radikalizuar gjatë fazave të ndryshme të “ciklit të jetës” ekstremist, që përfshin periudhën para se të bëhen pjesë e një grupi apo rrjeti, si anëtarë aktivë apo pas largimit të tyre. Qëllimi i këtij procesi mund të jetë pengimi i përfshirjes së tyre në dhunë (deradikalizimi sjellor), apo ndryshimi i qëndrimeve të tyre dhe supozimeve ideologjike (radikalizimi njohës).

**Mungesa e angazhimit** – është veprimi apo procesi i largimit nga përfshirja në një veprimtari, situatë apo grup. Në këtë rast, ai është një proces përmes së cilit një individ heq dorë nga pjesëmarrja aktive në një grup apo veprimtari radikale. Ky proces ndryshimi nuk nënkupton domosdoshmërisht që ky person ka hequr dorë nga pikëpamjet e tij ose saj politike apo ideologjike.

**Ekstremizmi** – Ekstremizmi mund të përdoret për t'iu referuar ideologjive politike që kundërshtojnë vlerat dhe parimet bazë të shoqërisë, dhe konsensusin social. Megjithatë, fjala ekstremist nuk mund të kufizohet në ideologji të ndryshme, pasi përdoret edhe për të treguar diçka përtej të zakonshmes apo një kundërshtim të fortë ndaj një gjëje të caktuar. Në kontekstin e demokracive liberale, kjo mund të gjejë zbatim në çdo lloj ideologjie që përkrah epërsinë dhe/ose kundërshton parimet bazë të demokracisë dhe të të drejtave universale të njeriut.

**Luftëtarë të huaj** – janë individë që shkojnë në një tjetër shtet që nuk është shteti i tyre i qëndrimit ose kombësisë me qëllim hyrjen, planifikimin, përgatitjen dhe pjesëmarrjen në akte terroriste, ose që ofrojnë apo marrin trajnim terrorist, lidhur me konfliktet e armatosura.

**Shkolla Hanefi** – një nga katër shkollat kryesore (*medh'hebi*) të arsytimit ligjor të Islamit Suni dhe të të besuarve të ligjit pozitiv. U mbështet te mësimet e Ebu Hanifes. Është shkolla më e përhapur e Sheriatit, e ndjekur nga pothuajse një e treta e botës myslimane. Doktrinat hanefi janë konsideruar gjithmonë si më fleksiblet dhe liberale në Sheriat, duke përfshirë edhe fushat e të drejtës penale, trajtimin e personave jomyslimanë, liritë individuale, martesën dhe kujdestarinë, dhe pronësinë e përdorimin e pronës.

**Imam** – personi që udhëheq faljet në xhami apo udhëheqës ligjor i një komuniteti mysliman.

**Islamofobia** – një armiqësi dhe frikë e pabazë ndaj Islamit, dhe për rrjedhojë, një frikë dhe mospëlqim ndaj të gjithë myslimanëve apo shumicës së tyre. I referohet edhe pasojave praktike të kësaj armiqësie në lidhje me diskriminimin, paragjykimin, trajtimin e pabarabartë (ndaj individëve apo komuniteteve) dhe përjashtimin e myslimanëve nga fushat kryesore politike dhe sociale.

**Medrese** – Fjala në gjuhën arabe për “shkollë, kolegji” me origjinë nga fjala *darasa* “për të studiuar.” Për qëllime të këtij studimi, ky term i referohet shkollës fetare myslimane.

**Mesxhid/ Musallat** – kongregacione apo vend takimesh të vogla dhe jozyrtare për myslimanët. Zakonisht marrin pjesë grupe të vogla me persona që ndajnë mendime të përbashkëta. Para-xhemat është një fjalë tjetër e përdorur zakonisht për t’iu referuar këtyre lloj *takimeve*’.

**Myfti** – udhëheqësi i komunitetit fetar mysliman në një rajon të caktuar të një shteti. Myftinj të janë autoriteti më i lartë ligjor lidhur me interpretimin e Kuranit dhe rregulloreve fetare në një komunitet të caktuar mysliman.

**Radikalizmi** – procesi i krijimit të besimeve ekstreme politike, ideologjike dhe fetare. Lidhet me përkrahjen gjithëpërfshirëse të ndryshimit politik, mbështetur në besimin se vazhdimi i status quo-së nuk është i pranueshëm. Mund edhe të karakterizohet nga prirja e të qenit jotolerant ndaj vlerave bazë të demokracisë, si për shembull ndaj barazisë dhe diversitetit.

**Radikalizimi** – procesi me anë të të cilit individët dhe grupet mund të bëhen jotolerantë për sa i përket vlerave bazë demokratike, si barazia dhe diversiteti, ashtu si edhe një prirje në rritje ndaj përdorimit të forcës për përmbushjen e qëllimeve politike që mohojnë dhe/apo cenojnë demokracinë.

**Ekstremizmi fetar** – mund të karakterizohet si ndjekje e programit të rinovimit shoqëror në emër të një doktrine fetare. Përdorimi i dhunës justifikohet duke iu referuar një autoriteti hyjnor, një të vërtetë absolute apo interpretimi të fjalëpërfjalshëm të teksteve që konsiderohen të shenjta. Grupe të caktuara njerëzish, si për shembull: jobesimtarët, paganët, felëshuesit apo heretikët identifikohen si armiq dhe si të tillë, damkosen si të nënshtruar, ndëshkuar, përjashtuar, apo të vrarë në emër të një apo një tjetre kauze të shenjtë.

**Radikalizmi fetar** – shqetësime që lidhen me *rrënjët* e fesë, që nënkupton njohjen dhe praktikimin e fesë që përputhet me burimet fetare, siç janë interpretuar dhe përjetuar nga besimtarët e parë. Prandaj, ai përqendrohet tek ortodoksia dhe ortopraksia.

**Toleranca / toleranca fetare** – është një prirje për të rezistuar dhe duruar besimet dhe praktikatat e të tjerëve, me të cilat nuk janë dakord sepse ai ose ajo i mendon si të gabuara apo të pasakta. Toleranca përfshin një qëndrim të ndërmjetëm midis pranimin me plot zemër dhe kundërshtimit të shfrenuar. Toleranca fetare mund të përkufizohet si njohje e të drejtës së gjykimit privat të çështjeve fetare, lirisë për të përkrahur mendimet fetare dhe formave të admirimit të një personi, apo për të gëzuar të gjitha privilegjet shoqërore, etj., pa marrë parasysh dallimet fetare.

**Qëndresa / komunitet i qëndrueshëm** – *Qëndresa* mund të përkufizohet si cilësia e të qenit i aftë për t'u kthyer menjëherë në gjendjen e mëparshme pas problemeve, apo si aftësia për të përballuar, reaguar dhe për të marrë veten nga një sërë ngjarjesh të dëmshme dhe pafavorshme. *Komunitet i qëndrueshëm* i referohet një ndërhyrjeje apo angazhimi aktiv të palëve të ndryshme të interesit të komunitetit, të veshur me autoritet për parandalimin apo luftimin e EDH-së.

Këtu përfshihet edhe qëndrimi i komunitetit ndaj një fenomeni të tillë dhe reagimi i tij në rast të një veprimtarie EDH-je apo të ngjarjeve që mendohet se i shkaktojnë ato.

**Selefizmi** – është ideja që Islami më autentik dhe i vërtetë gjendet te shembulli i brezave të parë dhe të drejtë të myslimanëve, e njohur si *salaf*, që ishin më afër në kohë dhe distancë me Profetin Muhamed. Selefët, të përshkruar shpesh si “ultrakonservatorë” nuk besojnë vetëm te “shpirti” por edhe te “teksti” i ligjit, që i dallon ato nga praktikantët e tjerë të zakonshëm (Hamid & Dar, 2016).

**Sheriati** – ligji zakonor islamik i mbështetur te mësimet e Kuranit dhe te traditat e Profetit (Hadith dhe Sunet), që urdhëron udhëzimet ligjore gjithëpërfshirëse dhe që janë të justifikueshme dhe të pranueshme për Islamin për të gjitha fushat e jetës, si detyrat fetare dhe laike, dhe nganjëherë edhe dënime ndëshkuese për shkeljen e ligjit. Zakonisht plotësohet nga legjislacioni i përshtatur me kushtet e ditës, , megjithëse mënyra se si duhet zbatuar në shtetet moderne është objekt i mosdakordësive ndërmjet tradicionalistëve dhe reformistëve myslimanë.

**Tekfir/ tekfirizëm** – veprimi apo praktika e deklarimit të një myslimani tjetër si fajtor për braktisjen e fesë (p.sh: mosbesimi në dogmat thelbësore të Islamit) dhe për rrjedhojë, nuk konsiderohet më mysliman.

**Terrorizmi** – vepra penale ndaj personave dhe pronave që, në bazë të natyrës apo kontekstit, mund të dëmtojnë vërtetë një shtet apo organizatë ndërkombëtare kur synojnë: frikësimin e një popullsie; detyrimin padrejtësisht të një qeverie apo organizate ndërkombëtare për të kryer apo për t'i frenuar ato nga kryerja e një akti; apo destabilizimin ose shkatërrimin e strukturës politike, ekonomike apo sociale të një shteti apo një organizate ndërkombëtare.

**Dhuna/ Ekstremizmi i dhunshëm** – dhuna përfshin veprimet me forcë që synojnë lëndimin e njerëzve apo që kanë gjasa të shkaktojnë dëme, ndërsa *ekstremizmi i dhunshëm*, siç përdoret në këtë kontekst, nënkupton pikëpamjet ekstremiste apo radikale, që plotësohen nga mbështetja, justifikimi, dhe përdorimi i ideologjisë të motivuar nga dhuna ndaj atyre që nuk ndajnë të njëjtat besime apo ideologji. EDH-ja është procesi i përshtatjes së këtyre pikëpamjeve radikale dhe transformimi i tyre në vepra të dhunshme.

**Cenueshmëria** – ngurrimi i një komuniteti, apo mungesa e mobilizimit për të ndërhyrë apo për t'u angazhuar në mënyrë proaktive në trajtimin e EDH-së, në kontekstin e dhënë, nënkupton një sërë karakteristikash dhe elementësh që mund të shtojnë rrezikun për një komunitet për të shfaqur format e EDH-së.

**Komunitet i cenueshëm** – është një komunitet që nuk është i aftë apo nuk mundet të parashikojë, përballojë, rezistojë apo marrë veten nga ekstremizmi. Për sa i përket EDH-së, ajo mund të kuptohet si potenciali i ekstremistëve të dhunshëm për të rekrutuar individët në kauzën e tyre dhe mundësisht për t'i angazhuar në akte të dhunshme.

**Uahabizmi** – është një degë fetare konservatore e islamit suni, së cilës i është vendosur emri në nder të dijetarit reformist të shekullit të XVIII, Muhamed ibn Abd el-Wahhab, që përkrahte rikthimin e besimeve dhe praktikave të hershme islamike.

# Bibliografia

Abu-Nimer, M. (2018). Alternative Approaches to Transforming Violent Extremism. The Case of Islamic Peace and Interreligious Peacebuilding. In Austin / Giessmann (bot.), *Transformative Approaches to Violent Extremism* (14-16). Berlin: Fondacioni "Berghof".

Instituti Shqiptar i Statistikave (n.d.). INSTAT.Nga Censusi i vitit 2011: <http://instatgis.gov.al/#!//prefectures/population/prefpop1>(marrë më 15 qershor 2018).

Azinović, V. (2017). *Between Salvation and Terror: Radicalization and the Foreign Fighter Phenomenon in the Western Balkans*. Sarajevë: Atlantic Initiative. [http://atlanticinitiative.org/wp-content/uploads/2017/05/imagesBetweenSalvationAndTerror\\_BetweenSalvationAndTerror.pdf](http://atlanticinitiative.org/wp-content/uploads/2017/05/imagesBetweenSalvationAndTerror_BetweenSalvationAndTerror.pdf) (marrë më 18 shtator 2018).

BalkanWeb. (16 qershor 2015). *Korçë, Janë vandalizuar statujat e Parkut Rinia, Reagon Bashkia: Është një vandalizëm që fyen çdo qytetar*. Nga BalkanWeb: <http://www.balkanweb.com/site/korce-demtohen-skulpturat-e-parkut-rinia-bashkia-akt-vandal-qe-fyen-cdo-qytetar/>(marrë më 13 maj 2018).

Beslin, J. dhe M. Ignjatijevic (2017). *Balkan Foreign Fighters: From Syria to Ukraine*. Paris: Instituti i Bashkimit Europian për Studime të Sigurisë (EUISS)

BIRN. (21 dhjetor 2014). *Origjinat e Islamit Radikal në Shqipëri*. Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative (BIRN): <https://www.reporter.al/zanafilla-e-islamit-radikal-ne-shqiperi/>(marrë(marrë më 22 maj 2018).

Block, D. (2013). *The Structure and Agency Dilemma in Identity and Intercultural Communication Research*. Lleida: Gjuha dhe Komunikimi Ndërkulturor.

Bogdani, A. (2016). Albania Faces 'Jihadi Fighters in the Shadows' Threat. Në BIRN, *Balkan Jihadists: The Radicalisation and Recruitment of Fighters in Syria and Iraq* (4-9). Tiranë, Shkup, Beograd, Sarajevë, Prishtinë: Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative.<http://www.balkaninsight.com/en/file/show/Balkan-Jihadists.pdf>(marrë më 15 qershor 2018).

Bunzel, C. (19 mars 2015). *From Paper State to Caliphate: The Ideology of the Islamic State*. Marrë nga Brookings: <https://www.brookings.edu/wp-content/uploads/2016/06/The-ideology-of-the-Islamic-State.pdf>(marrë më 30 prill 2018).

Projekti i Luftës kundër Ekstremizmit (2017) Shqipëri: Ekstremizmi dhe Lufta kundër Terrorizmit. Marrë nga Projekti i Luftës kundër Ekstremizmit: <https://www.counterextremism.com/countries/albania>(marrë më 10 qershor 2018).

Këshilli i Ministrave. (18 nëntor 2015). *Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Plani i Veprimit*. Vendimi nr. 930 Tiranë: Fletorja Zyrtare.

Këshilli i Ministrave. (3 shkurt 2017). *Për ngritjen e Qendrës së Ekselencës së NATO-s në Shqipëri, për studimin e fenomenit të luftëtarëve të huaj* Vendimi nr. 58 Tiranë: Fletorja Zyrtare.

Këshilli i Ministrave. (13 dhjetor 2017). *Për ngritjen e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm*. Vendimi nr. 737 Tiranë: Fletorja Zyrtare.

Çobo, S. (26 shkurt 2016). "Imamët" rekrutuan edhe nëna me fëmijë, dërguan në Siri 70 luftëtarë. Marrë nga Gazeta Shqip: <http://gazeta-shqip.com/lajme/2015/02/26/imamet-rekrutuan-edhe-nena-me-femije-derguan-ne-siri-70-luftetare/>(marrë(marrë më 14 maj 2018).

Dyrmishi, A. (2017). Radikalizimi dhe Qeverisja e Islamit në Shqipëri. In V. Azinović, *Between Salvation*



- and Terror: Radicalization and the Foreign Fighter Phenomenon in the Western Balkans. Sarajevë: Atlantic Initiative.
- Eisenstein, M. (2008). Religion and the Politics of Tolerance: How Christianity Builds Democracy. Waco: Baylor University Press.
- Ellis, B.H. dhe S. Abdi. (2017) Building Community Resilience to Violent Extremism Through Genuine Partnerships. *American Psychologist*, 72 (3), 289-300.
- Komisioni European. (2018). Raporti për Shqipërinë 2018. Strasburg: Komisioni European.
- Fearon, J. (1999). What is Identity: as We Now Use the Word. Stanford, Kaliforni: Universiteti i Stanfordit.
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. (28 janar 2018) Trajnimi i stafit të sistemit të burgjeve për parandalimin e radikalizimit në burgje. Tiranë.
- Hafez, M. dhe C. Mullins (2015). The Radicalization Puzzle: a Theoretical Synthesis of Empirical Approaches to Homegrown Extremism. *Studies in Conflict and Terrorism*.
- Hamid, Sh. dhe R. Dar (2016). Islamism, Salafism and Jihadism. A Primer. Blog. Uashington, DC: Institucioni Brookings. <https://www.brookings.edu/blog/markaz/2016/07/15/islamism-salafism-and-jihadism-a-primer/> (marrë më 18 shtator 2018).
- Hide, E. (2015). Vlerësimi i rreziqeve për sigurinë kombëtare/ aftësia e shtetit dhe shoqërisë shqiptare për të reaguar: Ekstremizmi i dhunshëm dhe Radikalizimi Fetar në Shqipëri. Tiranë: Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare.
- Holman, T. (Qershor 2014). Foreign Fighters from the Western Balkans in Syria. Marrë nga CTC Sentinel: <https://ctc.usma.edu/foreign-fighters-from-the-western-balkans-in-syria/> (marrë më 16 prill 2018).
- Jones, E. (2013). Identity, Solidarity, and Islam in Europe. *The International Spectator* , 102-116.
- Kelmendi, V dhe Sh. Balaj (2017). Fushëbetejat e reja: Aktivitetet e grupeve ekstremiste në rrjetet sociale në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni. Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.
- Kullolli, A. (2009). Proselytization in Albania by Middle Eastern Islamic Organizations. Institutional Archive of the Naval Postgraduate School.
- Kumar, K. dhe G. Geethakumari (2014). Detecting Misinformation in Online Social Networks Using Cognitive Psychology. *Human-centric Computing and Information Sciences* , 3.
- Ligji nr. 7502 dhe nr. 8580. (1991 dhe 2000). Për Partitë Politike Fletorja Zyrtare.
- Ligji nr. 7952. (21 qershor 1995). Për arsimin parauniversitar. Fletorja Zyrtare.
- MAPO. (12 mars 2014). Zbulohet rrjeti që rekrutonte luftëtarët shqiptarë të Sirisë. <http://www.mapo.al/zbulohet-rrjeti-qe-rekrutonte-luftetaret-shqiptare-te-sirise-kush-jane-dy-imamet-e-xhihadit-luftarak/comment-page-1/> (marrë më 17 gusht 2018).
- Mejdini, F. (17 dhjetor 2015). Uncontrolled Mosques Proliferate in Albania. Marrë më 30 prill 2018, nga Rrjeti Ballkanik për Gazetarinë Investigative: <http://www.balkaninsight.com/en/article/state-slams-albanian-muslim-over-uncontrolled-mosques-12-17-2015>, (marrë më 30 prill 2018).
- Michael, G. (2014). Counterinsurgency and Lone Wolf Terrorism. *Terrorism and Political Violence* , 46–47.
- Neumann, P. R. (2017). Countering Violent Extremism and Radicalisation that Lead to Terrorism: Ideas, Recommendations, and Good Practices from the OSCE Region. Londër: OSBE.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. (1995, 1 27). Ligji nr. 7895. Tiranë.

Qendra Kërkimore Pew. (2012). *The World's Muslims: Unity and Diversity*. Uashington DC: Qendra Kërkimore Pew.

Reed, A., dhe J. Pohl (2017, 7 14). *Tackling the Surge of Returning Foreign Fighters*. International Center for Counter-Terrorism - The Hague.

Romero, D. (14 prill 2018). *From Arab Spring to chemical attacks: A timeline of the Syrian conflict and the U.S. response*. Marrë nga NBC News: <https://www.nbcnews.com/news/us-news/arab-spring-chemical-attacks-timeline-syrian-conflict-n865961> (marrë më 30 prill 2018).

Scanlon, T. (1996). *The Difficulty of Tolerance*. Princeton: Princeton University Press.

Selimi, K. dhe F. Stojkovski (2016). *Assessment of Macedonia's Efforts in Countering Violent Extremism, View from Civil Society*. Skopje: Analytica. [https://www.analyticamk.org/images/Files/extremism-en-updated-FINAL-web\\_ceb98.pdf](https://www.analyticamk.org/images/Files/extremism-en-updated-FINAL-web_ceb98.pdf) (marrë më 14 maj 2018).

ShtetiWeb. (8 dhjetor 2013). *Kushtetuta Provizore e Republikës së Shqipërisë. (1991)*. Marrë nga ShtetiWeb: <http://shtetiweb.org/2013/10/08/dispozitat-kryesore-kushtetuese-1991/> (marrë më 30 qershor 2018).

Shtuni, A. (2015a). *Breaking down the Ethnic Albanian Foreign Fighters Phenomenon*. *Soundings: An Interdisciplinary Journal*, 98 (4), 460-477.

Shtuni, A. (2015b). "Ethnic Albanian Foreign Fighters in Iraq and Syria," *Counter Terrorism Center: Sentinel*, Vëll. 8, Nr. 4, prill 2015.

Shtuni, A. (2016). *Dynamics of Radicalization and Violent Extremism in Kosovo*. Uashington DC: Instituti i Paqes i Shteteve të Bashkuara.

SotNews (3 maj 2016). «Xhihadistët», jepet vendimi për 9 imamët e vetëshpallur, ja sa vite burg rëndojnë mbi secilin. Marrë nga Sot News: <https://sot.com.al/aktualitet/xhihadist%C3%ABt-jepet-vendimi-p%C3%ABr-9-imam%C3%ABt-e-vet%C3%ABshpallur-ja-sa-vite-burg-r%C3%ABndojn%C3%AB-mbi> (marrë më 18 prill 2018).

Spahiu, E. (2017). *Migrantët shqiptarë dhe rreziku i radikalizimit*. In V. Azinović, *Between Salvation and Terror: Radicalization and the Foreign Fighter Phenomenon in the Western Balkans* (31-42). Sarajevë: Atlantic Initiative.

Telegrafi. (16 nëntor 2016). *Policia e Kosovës: Arrestuam 19 persona që planifikonin sulme terroriste*. Marrë nga Telegrafi: <https://telegrafi.com/policia-e-kosoves-arrestuam-19-persona-qe-po-planifikonin-sulme-terroriste/> (marrë më 18 prill 2018).

Telegrafi. (15 dhjetor 2014). *The Path of Albanian Jihadists to Syria*. Marrë nga Telegrafi: <https://telegrafi.com/kjo-eshte-rruga-e-shqiptareve-drejt-xhihadit-ne-siri/> (marrë më 14 maj 2018).

Turčalo, Sead. (2018). *Workshop Discussion. Building Community Resilienceto VE*. Berlin, Gjermani.

USAID. (2011). *Conflict Assessment Framework*. Uashington DC: USAID.

Vickers, M. (2008). *Islam in Albania*. Swindon: Defence Academy of the United Kingdom.

Vurmo, Gj. etj. (2018). *Toleranca Fetare në Shqipëri*. Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe UNDP. <http://idmalbania.org/religious-tolerance-albania/> (marrë më 18 shtator 2018).

Vurmo, Gj. etj. (2015). *Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri*. Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/07/Religious->

Radicalism-Albania-web-final.pdf (marrë më 18 shtator 2018).

Zeuthen, J. dhe M. Zeuthen. (2016). Countering Violent Extremism and Risk Reduction: a Guide to Program Design and Evaluation (2-16). Uestminster: RUSI.

Zoto, E. (2013). Failure and Success of Jihadi Information Operations on the Internet. Monterey: Naval Postgraduate School.

## Referencat e kërkimit në terren (FG-të dhe Intervistat)

Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet, Kavajë (19 janar 2018) Komunikim personal. (Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Intervistues)

Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet, Korçë (22 janar 2018) Komunikim personal. (Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Intervistues)

Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet, Tiranë (11 janar 2018) Komunikim personal. (R. Qirjazi, Intervistues)

Oficerët e Policimit në Komunitet, Tiranë. (11 janar 2018) Komunikim personal. (R. Qirjazi, Intervistues)

Praktikante të fesë islame në Kavajë në Korçë. (5 mars 2018). Fokus grup. (D. Jashari, Intervistues)

Imam në Korçë. (5 mars 2018). Komunikim personal. (Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Intervistues)

Imam në Tiranë. (16 janar 2018) Komunikim personal. (Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Intervistues)

Imam në Kavajë. (18 janar 2018) Komunikim personal. (Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Intervistues)

Myftiu i Kavajës. (12 janar 2018) Komunikim personal. (Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Intervistues)

Myftiu i Korçës. (22 janar 2018) Komunikim personal. (Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Intervistues)

Myftiu i Tiranës. (13 janar 2018) Komunikim personal. (Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Intervistues)

Praktikantë të fesë islame në Kavajë (21 shkurt 2018). Fokus grup. (Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Intervistues)

Praktikantë të fesë islame në Tiranë. (11 maj 2018) Fokus grup. (Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Intervistues)

Përfaqësues i Bashkisë së Kavajës. (31 janar 2018) Komunikim personal. (Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Intervistues)

Përfaqësues i Bashkisë së Korçës. (22 janar 2018) Komunikim personal. (Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Intervistues)

Përfaqësues i Bashkisë së Tiranës. (10 janar 2018) Komunikim personal. (Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Intervistues)

Përfaqësues të Shoqërisë Civile në Kavajë. (1 mars 2018). Fokus grup. (Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Intervistues)

Përfaqësues të Shoqërisë Civile në Korçë. (21 mars 2018). Fokus grup. (Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Intervistues)

Përfaqësues të Shoqërisë Civile në Tiranë. (24 prill 2018). Fokus grup. (Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, Intervistues)

